



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Marrëdhënie
Ndërkombëtare dhe Diplomaci”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Merita Xhumari

Prof As. Islam Jusufi

Shkurt/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”
Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës – UAMD
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Shkencor “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 207, datë 31.05.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASR Nr. 515, datë 24.10.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2019-2020 9 PAE/ 6 PAK 2020-2021 12 PAE/5 PAK 2021-2022 15 PAE/1 PAK
18	Numri i studentëve:	18 studentë 2019-2020 15 studentë 2020-2021 35 studentë 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës - UAMD”, është i licencuar me emrin “Gjeopolitika dhe Sistemet e Sigurisë” me Urdhër të Ministrit Nr. 207, datë 31.05.2013 dhe riorganizuar në vitin 2019 me emrin “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” me Urdhër të Ministrit Nr. 515, datë 24.10.2019, si programi i ciklit të dytë, Master i Shkencave, me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike.

Programi i studimit, i ofron studentit aftësim, kompetencë dhe njohuri veçanërisht në aspekte të cilat kanë të bëjnë me njohjen, kuptimin dhe analizën e proceseve të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë nëpërmjet ndërthurjes së teorisë me aftësitë praktike, orëve të mësimin në auditor me punë të pavarur për të inkurajuar aftësitë analitike, si dhe ekspertizën vendase në fushën e teorisë me atë të praktikës, duke i mundësuar studentit vazhdimin e një karriere të mëtejshme në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë. Kurrikula e programit të studimit ofron formim në politikë, marrëdhëniet ndërkombëtare, histori dhe ligj. Qëllimi i tij është të përgatisë figura profesionale të afta të punojnë në institucionet publike kombëtare dhe ndërkombëtare, në OSHC dhe institucione kërkimore, referuar objektivave të tij dhe praktikave ku orientohen studentët para diplomimit, apo brezit t^{ri} parë të studentëve të sapodiplomuar.

Format e mësimdhënies përfshijnë orë në auditor, punë në grup dhe punë kërkimore individuale. Syllabuset përmbajnë elementët e nevojshëm dhe forma e vlerësimit të studentit është kombinimi i punimit të eseve, me provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare të lëndës, apo projektet e kursit. Personeli akademik ka kualifikimin e përshtatshëm, me eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Departamenti i Shkencave Politike ku realizohet programi i studimit, krahas stafit akademik e ndihmës akademik të brendshëm, ka edhe një rrjet bashkëpunëtorësh si nga institucionet homologe brenda e jashtë vendit, me të cilët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, si për projekte të përbashkëta kërkimore shkencore, ashtu edhe për praktikën e studentëve dhe mundësitë e punësimit të tyre pas diplomimit. Politikën, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit përfshijnë të gjithë aktorët e interesuar, strukturat, stafet akademike, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Ato diskutohen në takime dhe evente të organizuara në UAMD, me synim krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë. Infrastruktura në kampusin e ri universitar garanton cilësi dhe akses të barabartë për përdorimin e teknologjive të informacionit, bibliotekës online dhe internetit si brenda dhe jashtë godinës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmbledh informacione të mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin një situatë sa më reale, për mënyrën se si performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat GVJ është njohur që në fillim të angazhimit të tij. GVJ është i përbërë nga ekspertët Prof. Dr. Merita Xhumari dhe Assoc. Prof. Dr. Islam Jusufi. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Alma Arapi dhe Erjon Xhako, përfaqësues të ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumenta dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB). Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e këtij raporti. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucionin në datat 21 dhe 22 Qershor 2023 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga përfaqësues të ASCAL (Agjenda bashkangjitur). Gjatë vizitës dhe vlerësimit u vu re një disponibilitet nga strukturat akademike dhe administrative të institucionit për t'i vënë në dispozicion GVJ dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e programit. Drejtuesit e institucionit, Fakultetit të Shkencave Politike Juridike dhe Departamenti të Shkencave Politike bënë një prezantim të kënaqshëm të programit e më pas Grupi i Vlerësimit të Brendshëm diskutoi në detaje për raportin e tyre ku janë përpjekur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë e ofruar nga programi i studimit. Bisedat me stafin akademik dhe studentët ofruan informacion të drejtpërdrejtë të përpjekjeve të tyre për përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Takimi me përfaqësues të NJSBC dhe të Drejtorisë së Kurrikulave konfirmuan faktet për proceset e sigurimit të cilësisë në UAMD. Kontaktet gjatë vizitës u përmbyllën me shqyrtimin e të dhënave statistikore në sekretariatë mësimore dhe inventarit të fondit të Bibliotekës së UAMD. Vizita u mbyll me njohjen e mjediseve, sallave, auditoreve, laboratoreve ku zhvillohej procesi mësimor për këtë program studimi. Vlerësimi është përgjithësisht pozitiv me pikat e forta të identifikuar dhe disa nota kritike për dobësitë. GVJ është i mendimit se programi i ka përmbushuar plotësisht kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i akreditimit.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.01.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19 / 3 Prot, datë 12.01.2024. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës njofton në ASCAL më datë 29.01.2024, me anë të shkresës me Nr.108/1 Prot, datë 19.01.2024 " Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD)

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” (MND) pranë Departamentit të Shkencave Politike (DSHP) në Fakultetin i Shkencave Politike-Juridike (FSHPJ) të Universitetit ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës (UAMD) është në përputhje me interesat dhe synimet strategjike të zhvillimit politiko-ekonomik të vendit. Ky program studimi është në linjë me politikën kombëtare të avancimit e aftësive të studentëve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Programi i studimit MND është në përputhje me zhvillimet politike të vendit pasi ai trajton proceset dhe temat aktuale të zvillimeve politike, ekonomike, sociale dhe juridike (<i>Ref. Evidencë 1. Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Nenet 3-4; Evidencë 2.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025, Kapitujt I-IV; Evidencë 85. Mendimi i Dekanit, fq. 1).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit MND ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e UAMD, për formimin akademik të studentëve në fushën e studimeve shoqërore-politike, me ndikim në vend, rajon e më gjerë. Programi i studimit ofrohet në drejtim të avancimit të arsimit të lartë dhe të shkencës, që është pjesë e misionit dhe vizionit të institucionit (<i>Ref. Evidencë 1. Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Nenet 3-4; Evidencë 2.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025, Kapitujt I-VI).</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet	Programi i studimit MND mbështet misionin e institucionit për arsimin e lartë me përgatitjen e studentëve me cilësi dhe me mendim kritik e analitik, përfshirë edhe në fushat e shkencave sociale dhe humane, që është një nga shtyllat kryesore të veprimarisë së institucionit (<i>Ref. Evidencë 1. Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Nenet 3-4; Evidencë 6. Rregullore e UAMD, Neni 10; Evidencë 7. Rregullore e FSHPJ, Neni 9).</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

6

akademike së Institucionit.									
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Ky program studimi është në përputhje me zhvillimet strategjike kombëtare pasi ofron ekspertizë në lidhje me zhvillimet politike dhe proceset të bashkëpunimit ndërkombëtar. Ky program studimi, pajis studentët me aftësi të mira teorike dhe praktike, duke pasur parasysh synimet e përcaktuara në dokumentet strategjike kombëtare si p.sh Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 2022, dhe Agjenda 30 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Riorganizimi i programit në vitin 2019 nga “Gjeopolitika dhe Sistemet e Sigurisë” në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”, është bërë në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me realitetet e reja në vend dhe më gjerë (Ref. Evidencë 22. Urdhër MASR riorganizimi, fq. 1-2; Evidencë 4. Plani Strategjik i Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 5. Pani Strategjik i Zhvillimit të masterit shkencor MND; RVB, fq. 9; Takimi me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP).								
Konkluzione	<i>Programi i studimit MND është në linjë me politikën kombëtare të avancimit e aftësive të studentëve në fushën e studimeve shoqërore-politike, me ndikim në vend e më gjerë. Programi i studimit ofrohet në drejtim të avancimit të arsimit të lartë dhe të shkencës, që është pjesë e misionit dhe vizionit të institucionit. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë	UAMD ka një përvojë afro 10 vjeçare në fushën e studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci, me përfshirjen e stafi akademik, studiuesve dhe personaliteteve të kualifikuara dhe me përvojë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. Kapacitetet dhe burimet materiale dhe njerëzore janë të mjaftueshme për zhvillimin e programit të studimit (Ref. Evidencë

fushë.	2.1. <i>Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025, fq. 6-15; Evidencë 69. Përmbledhëse stafi me kohe të plotë ndër vite; Evidencë 65. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit; Evidencë 162. Stukturë FSHPJ 2022-2023; RVB, fq. 10; Takimet me drejtuesit dhe me stafin akademik).</i>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik të FSHPJ. FSHPJ si Fakultet është organizuar në tre departamente/njësi bazë dhe programi i studimit MND ofrohet nga një prej tre njësi bazë të FSHPJ. Njësia kryesore FSHPJ është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat akademike e kërkimore për të ofruar një program të tillë. DSHP përfaqësohet në mënyrë të duhur në organet drejtuese të FSHPJ. Fushat e studimit dhe kërkimit të njësisë kryesore kanë rëndësi për lëminë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. Gjithashtu programi MND organizohet në nivelin 7 sipas kornizës evropiane dhe kombëtare të kualifikimeve (<i>Ref. Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; Evidencë 92. Kodifikimi i Programeve UAMD; Evidencë 34. Organigramë FSHPJ; Evidencë 43. Fushat e Kërkimit Shkencor FSHPJ; RVB, fq. 10; Takimi me drejtuesit e FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit MND është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të DSHP i cili është përgjegjës për programin e studimit. Njësia bazë DSHP është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat e nevojshme për të ofruar një program të tillë. MND është një program i cili është hartuar duke patur parasysh misionin e DSHP dhe veprimtarinë kërkimore shkencore të anëtarëve të tij. Kjo del në pah nga lista e aktiviteteve kërkimore e shkencore dhe të ekspertizës së personelit akademik. DSHP ofron programe të ngjashme bachelor dhe master shkencor në marrëdhënie ndërkombëtare dhe shkenca politike, të cilat përbëjnë 3 nga 6 programet e ofruara nga departamenti. Së fundmi, avancimi në vitin akademik 2023-2024 me diplomë të dyfishtë Bachelori në Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomaci me Universitetin e Genovës përforcojnë ekspertizën thelbësore të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci të një departamenti të shkencave politike (<i>Ref. Evidencë 5. Pani Strategjik i Zhvillimit</i></p>



	<i>te masterit shkencor MND; Evidencë 54. FSHPJ Staf Akademik 2019-2020; RVB, fq. 10; Takimi me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP).</i>			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	<i>Nuk aplikohet.</i>			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<i>Institucioni ka disa korniza për formimin profesional të studentëve të diplomuar në bashkëpunim me rjetet e tij të diplomuar dhe me institucionet publike dhe private me të cilat ka krijuar një bashkëpunim (Ref. Evidencë 159. Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni; Evidencë 112. Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet; RVB, fq. 11; Takimi me studentët e programit të studimit).</i>			
Konkluzione	<i>MND është një program i cili është hartuar duke patur parasysh misionin e FSHPJ dhe DSHP dhe veprimtarinë akademike dhe kërkimore shkencore të anëtarëve të tyre. Fusha akademike e njësisë bazë si avancimi në vitin akademik 2023-2024 me diplomë të dyfishtë Bachelori në Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomaci me Universitetin e Genovës përforcojnë ekspertizën thelbësore të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit,	<i>Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit është e përcaktuar në Statutin dhe Rregulloret e UAMD, FSHPJ, DSHP dhe programit të</i>

<p>siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>studimit MND. Programi varet nga njësia bazë DSHP. Kjo e fundit është përgjegjësi kryesore për mbarëvajtjen e tij. Marrëdhëniet me njësi të tjera të Fakultetit dhe të Universitetit lidhen me aspekte të financave, burimeve njerëzore dhe sigurimit të cilësisë (Ref. Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 11; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, dhe me përfaqësuesit e drejtorive administrative të institucionit).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh me institucione kombëtare, kombëtare lokale dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, Universiteti shfrytëzon marrëveshjet e mobilitetit Erasmus + dhe Horizon 2020 me universitete të ndryshme që mundësojnë shkëmbime të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve. Megjithatë, ka një numër të kufizuar marrëveshesh bashkëpunimi të nënshkruara me institucionet që lidhen drejtpërdrejt me temën e programit të studimit MND (Ref. Evidencë 45. Marrëveshjet e bashkëpunimit FSHPJ; Evidencë 45.1. Shembull Marrëveshje Bashkëpunimi me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Evidencë 45.2. Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD; Evidencë 45.3. Marrëveshjet Raport Vjetor UAMD 2021-2022; Evidencë 45.4. Memorandum Bashkëpunimi mes UAMD dhe Crystal System Group; Evidencë 80. Erasmus - Interinstitutional Agreement 2014-2021 and 2015-2021 for mobility for learners; Evidencë 58. Të dhënat mbi mobilitetet; RVB, fq. 11-12; Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon</p>	<p>UAMD vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me institucione që ofrojnë mundësi të kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Praktikave profesionale realizohen në bazë të marrëveshjeve që institucioni ka me organizma të ndryshëm. Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale apo stazhit. UAMD ka nënshkruar marrëveshje me institucione sikurse në rastin e Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, qarkun dhe bashkinë Durrës. Jo të gjitha praktikave profesionale kryhen në kuadër të këtyre marrëveshjeve. Studentët kanë gjithashtu liri të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

10



<p>me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>zgjedhin dhe negociojnë mundësitë për kryerjen e praktikës profesionale në institucionet me të cilat janë në kontakt. Në shumicën e rasteve, praktika profesionale drejtohet nga iniciativa e studentëve. Secili student mbikëqyret nga një supervisor te institucioni pritës. Programi i studimit MND parashikon praktikë profesionale të detyrueshme, me 6 ECTS, zhvilluar në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Për njohjen e praktikës studenti udhëhiqet nga një pedagog mbikëqyrës dhe në fund dorëzon edhe një raport mbi përvojën e punës, relevancën dhe dobishmërinë për qëllimet akademike. Praktikant profesionale si dhe marrëveshjet me institucionet në të cilat ato zhvillohen përputhen plotësisht me qëllimet dhe objektivat e programit. Ato kryehen në bazë të drejtimeve kryesore të programit si dhe të kompetencave që ai ofron. Megjithatë, specifikisht për programin e studimit MND, marrëveshjet e nënshkuara për qëllime të kryerjes së praktikës profesionale është e kufizuar dhe mungon një bazë me të dhëna të palëve të treta të interesuara, të cilët mund të përdoren për vendosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të objektivave të praktikave profesionale (Ref. Evidencë 45. Marrëveshjet e bashkëpunimit FSHPJ; Evidencë 15. Udhëzues Praktika Master DSHP 2021-2022; Evidencë 44. Shembull praktike; Evidencë 45.1 Shembull Marrëveshje Bashkëpunimi me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; RVB, fq. 11-12; Takimi me studentët e programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nuk ka informacione për një praktikë të tillë. Dokumentacioni i servirur ofron vetëm një vlerësim të raportit të përgjithshëm i DSHP. Nuk ka një raport të përditësuar analitik të përfitimeve nga bashkëpunimi me universitetet partnere në funksion të realizimit të programit të studimit (Ref. Evidencë 146. Analiza e Departamentit të Shkencave Politike; RVB, fq. 12).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka krijuar strukturën e nevojshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe ka nënshkuar marrëveshje me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Megjithatë, ekziston një numër i kufizuar i marrëveshjeve të nënshkuara me qëllim specifik të praktikës profesionale. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush kryesisht kërkesat e standardit.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është i organizuar në lëndë, të vlerësuara nga 6 kredite ECTS, dhe të shtrira në 4 semestra me 30 ECTS për çdo semester. Gjithsej programi përmban 120 ECTS. Programi përmban: 14 lëndë të detyrueshme (lëndë të detyrueshme: Kërkim në Shkenca Sociale; Gjeopolitika, Konceptet, Teoritë dhe Aktorët; Shteti dhe Gjeopolitika; Organizatat Ndërkombëtare; Globalizimi, Varfëria dhe Migrimi; Historia Moderne e Botës; Marrëdhëniet Ndërkombëtare pas 1945; Krizat dhe Menaxhimi i Konfliktëve; Sistemet Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Terrorizmi; Politika e Jashtme e ShBA-së; Diplomacia dhe analiza e politikës së jashtme; Teoritë e Vendimarrjes; Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Lindjes së Mesme; Politikat e zhvillimit) (me 6 ECTS secila); 2 lëndë me zgjedhje nga 4 (lëndë me zgjedhje: Të drejtat e njeriut në politikën ndërkombëtare; Integrimi Evropian; Teoritë Politike të Multikulturalizmit; E drejta ndërkombëtare publike (me 6 ECTS secila); Praktika profesionale (me 6 ECTS); dhe Punimi i diplomës – Mikroteza (18 ECTS). Ky ndarje respekton plotësisht legjislacionin kombëtar Ligj Nr. 80/2015, datë 25.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (Ref. Evidencë 24. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)-Master MN&D 16'-20'; Evidencë 24.1. Plani mesimor 20'-

	<i>22' dhe Syllabuse DSHP; RVB, fq. 13).</i>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit MND me ofrimin e lëndëve të detyrueshme dhe ata me zgjedhje mbulon drejtimet kryesore të disiplinës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjithashtu struktura e programit të studimit ofron njohuri bazë dhe të thelluara, si dhe trajtime të specializuara dhe empirike të çështjeve specifike që lidhen me fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Njëkohësisht ata formohen në kompetenca profesionale në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. Studentët të programit të studimit MND vijnë nga fusha të ndryshme formimi. Ata përgjithësisht janë punësuar në administratën publike dhe sektorin privat. Shprehitë që masteri MND u ofron i shërbejnë në punën e aktivitetin e tyre të përditshëm. Punimi i diplomës është një projekt kërkimor individual, i cili monitorohet nga një supervizor të specializuar në fushën përkatëse të specializimit të studentit. Njësia bazë angazhon resurset e brendëshme për supervizimin e punimit të diplomës. Megjithatë, në disa raste ngarkesa e supervizimit të punimeve të diplomës është e zhdrejtë në raport me numrin e pedagogëve që i ndjekin ato. Gjithashtu, ka një vëmendje të kufizuar ndaj teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare (Ref. Evidencë 27. Syllabuset në Master i Shkencave Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, formulari i apl; Evidencë 24.1. Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; Evidencë 5. Plani Strategjik i Zhvillimit të masterit shkencor MND; RVB, fq. 13-14; Takimet me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit MND).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi synon të japë edhe njohuri praktike mbi aspekte të ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. Parashikohet një ngarkesë prej 6 kreditesh (ECTS) për praktikën. Në bazë të dokumentacionit praktika zhvillohet në një institucion, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Ajo ndiqet nga mentori i Universitetit dhe ai i institucionit. Më pas shoqërohet me dokumentacionin përkatës. Është paraparë edhe obligimi përmbyllës që është përgatitja e një Mikroteze prej 18 kreditesh (ECTS) (Ref. Evidencë 15. Udhëzues Praktika Master DSHP 2021-2022; Evidencë 15.1. Udhëzues Diplomimi Master DSHP; Evidencë 24.1. Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; Evidencë 14. Struktura e Mikrotezës MND; Evidencë 14.1. Rregullore e tezës. MND; RVB, fq. 14).</p>

<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><i>Nuk aplikohet.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p><i>Nuk aplikohet.</i></p>



<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p><i>Nuk aplikohet.</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70</p>	<p>Ndërsa ka programe të ngjashme, nuk është zbuluar që të ketë një program me të njëjtin emër në vend. Megjithatë, programi i studimit MND është hartuar për të përmbushur nevojat përkatëse të mësimdhënies dhe formimit të praktikuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci (<i>Ref. Evidencë 24.1. Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP</i>).</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit MND është kodifikuar me kodin e brendshëm UAMD-MSH-70312. Por nuk ka informata nëse edhe lëndët janë të kodifikuara (<i>Ref. Evidencë 92. Kodifikimi i Programeve UAMD; RVB, fq. 15</i>).</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p><i>Nuk aplikohet.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi organizohet mbi aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare dhe aktet e rregulloreve të brendshme të institucionit. GVJ është i</i></p>

	<i>mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike (FSHPJ) si njësi kryesore dhe Departamenti i Shkencave Politike (DSHP) si njësi bazë ku ofrohet programi i studimit përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. DSHP si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit funksionon në bazë të legjislacionit mbi Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit, Rregullores së FSHPJ dhe asaj të DSHP. Ajo përmbush detyrimet ligjore e nën ligjore për organizimin e strukturës akademike. DSHP përbëhet nga numri i nevojshëm i personelit akademik. Departamenti ka në përbërjen e tij 18 anëtarë të personelit akademik dhe të gjithë janë Personel Akademik Efektiv (PAE), dhe nga këta 5 kanë tituj akademik (1 mban titullin Prof. Dr., dhe 4 Prof. Asoc. Dr.), dhe 13 janë me grada shkencore Doktor i Shkencave. Personeli akademik nga IAL-ja i angazhuar në këtë program studimi është gjithsej 18, i gjithi, me kohë të plotë dhe ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, personel me tituj dhe/ose grade shkencore. Raportet janë të drejta. Shpërndarja e orëve dhe norma nuk tejkalohen. Çdo pedagog është përgjegjës për dy lëndë. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi është ngritur me Urdhër të Dekanit të FSHPJ, Nr. 8, datë 3.2.2023, dhe përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit. Pranë zyrës së burimeve njerëzore është i depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar, përfshirë CV-të në format specifik dhe provat përkatëse. Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen në dosjen individuale të stafit, që GVJ e kishte mundësi për të parë gjatë vizitës te institucioni. Megjithatë, gjatë vëzhgimit, u pa se CV-të nuk përditësohen rregullisht (Ref.</p>



	Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 25. urdhri 8 2023 për ngritjen e GVB; Evidencë 69. Përmbledhëse stafi me kohe të plotë ndër vite; Evidencë 57. Udhezimi për ngarkesën mesimore; <i>Evidencë 162. Stukturë FSHPJ 2022-2023; RVB, fq. 15-16; Takimet me stafin akademik dhe me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP).</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore dhe ajo bazë kanë stafin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ligji në fuqi. Personeli akademik dhe ndihmës akademik i Departamentit të Shkencave Politike për praktikën mësimore bashkëpunon ngushtë me institucionet ku zhvillohen praktikën mësimore sipas planit mësimor, në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve Master. GVJ nga bisedat me studentët konfirmoi se Departamenti i drejtohet ata në praktika profesionale si në institucionet publike si Bshkia Durrës, Porti Durrës, Zyra e Punës, ashtu dhe OSHC që operojnë në qarkun e Durrësit. <i>(Ref. Evidencë 106. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Takimi me DSHP dhe studentët).</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	FSHPJ cakton një pedagog mbikqyrës, në rolin e koordinatorit të programit të studimit. Programi ka një koordinator i cili mbikqyr mbarëvajtjen e kursit dhe zhvillimin e programit. Koordinatori për këtë program studimi është caktuar Prof.As.Dr. Eva Teqja me Urdhër të Dekanit të FSHPJ, Nr. 121, datë 15.11.2018. Koordinatori është përgjegjës për t'u përballur me sfidat me të cilat përballë programi dhe për të zhvilluar plane për zhvillimin e tij. Koordinatori është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe raporton dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit në mënyrë periodike të drejtuesit të departamentit. Roli i koordinatorit është monitorimi i mbarëvajtjes së programit. Po kështu koordinatori raporton tek drejtuesit të njësisë për problemet apo sugjerimet e mundshme për përmirësimin e programit <i>(Ref. Evidencë 106. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; RVB, fq. 16; Takimi me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP).</i>
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike (FSHPJ) si njësi kryesore dhe Departamenti i Shkencave Politike (DSHP) si njësi</i>

Mora Cerri

	<i>bazë i plotësojnë kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	FSHPJ, si njësia kryesore dhe DSHP, si njësia bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit, kanë në dispozicion informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Koordinatori përgjegjës për këtë program studimi është hallka ndërlidhëse e cila mban kontakte me përgjegjësën e departamentit, e cila nga ana e saj raporton te dekani i fakultetit. Informacionet e nevojshme gjithashtu rrjedhin nga studentët te anëtarët e stafit akademik dhe nga anëtarët e stafit akademik te koordinatori i programit dhe te drejtuesi i departamentit (<i>Ref. Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 16-17; Takimet me stafin akademik, studentët dhe me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP</i>).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit organizohet në lëndë, praktikë dhe punimi i diplomës të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara sipas komponentëve mësimorë. Ky program i studimit ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (60 ECTS për vit) ose 4 semestra (30 ECTS për semestër). Po kështu ndarja është ajo e vitit në dy semestra. Lëndët janë të ndara në kredite 6 për 1 lëndë duke marrë si bazë sistemin ECTS. Plani mësimor jep edhe ngarkesën mësimore dhe orët në auditor ku çdo ECTS përbën 25 orë studimi (150 orë për 6 kredite), dhe në një vit akademik me 60 ECTS mesatarisht 1500 orë studimi. Plani mësimor është i qartë. Ai ndahet në dy semestra, me nga 30 kredite secili. Në semestrin e parë zhvillohen lëndë plotësuese dhe karakterizuese, të gjitha të detyrueshme. Në semestrin e dytë

	<p>zhvillohen lëndë bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore integruese. Në semestrin e tretë zhvillohen lëndë karakterizuese dhe ndërdisiplinore integruese. Në semestrin e katërt dhe e fundit zhvillohet një lëndë, praktika mësimore dhe punimi i diplomës. Lëndë Bazë (A) përbëjnë 6 ECTS (5%), Lëndë Karakterizuese (B) përbëjnë 66 ECTS (55%), Lëndë Ndërdisiplinore Integruese (C) përbëjnë 18 ECTS (15%), Lëndë Plotësues (D) përbëjnë 12 ECTS (10%) dhe Detyrime Përmbyllëse (E), Tema e Diplomës ose Mikroteza përbën 18 ECTS (15%). Përqindja totale e lëndëve sipas tipit të komponentit mësimor është sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.1.2018 Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë (<i>Ref. Evidencë 24.1 Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; RVB, fq. 17</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ndërsa rubrika në faqen e UAMD-së kushtuar programit të studimit MND ka disa informacione, atij i mungon informacioni më i detajuar për kushtet e pranimit, transferimit dhe njohjes së studimeve. Mobiliteti i studentëve përmes programeve të ndryshme evropiane është bërë e zakonshme dhe UAMD është bërë pjesë e këtij procesi. Megjithatë, procesi i njohjes së lëndëve të ndjekura gjatë mobilitetive në universitete të tjera është i rëndë mbrenda DSHP dhe dekurajues për studentët që dëshirojnë të shkojnë për mobilitet (<i>Ref. Evidencë 74. Programi i Transparencës së UAMD; Evidencë 58. Të dhënat mbi mobilitetet; RVB, fq. 17; Takimet me Zyrën e Projekteve, me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion të detajuar mbi strukturën e lëndës, tipin dhe përmbajtjen e kursit, mënyra e vlerësimit, objektivat specifike të lëndës, numri përkatës i orëve të leksioneve dhe seminarëve, përmbajtjen e temave, literaturën e detyrueshme dhe atë më zgjedhje, kompetencat dhe njohuritë që përfitohen nga to. Për çdo lëndë janë përcaktuar temat (ato variojnë nga 13 deri 15 tema për lëndë), format e mësimdhënies dhe ngarkesa mësimore (<i>Ref. Evidencë 27. Syllabuset në Master i Shkencave Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, formulari i apl; Syllabuset e lëndëve; RVB, fq. 17</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe</p>	<p>Syllabuset janë të detajuar dhe komunikohen vetë studentëve çdo fillim viti akademik, pasi përditësohen sipas nevojave. Rishikimi dhe përditësimi i lëndëve të ofruara nga programi i studimit është</p>

përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	kompetence e DSHP, dhe çdo silabus përditësohet dhe rishikohet, dhe miratohen përpara fillimit të çdo viti akademik nga departamenti. Megjithatë, literatura e dhënë në syllabuset, me kalimin e viteve, bëhen e vjetër. Është i nevojshëm përditësimi i vazhdueshëm i literaturës të syllabuset me botimet më të reja (<i>Ref. Evidencë 27. Syllabuset në Master i Shkencave Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, formulari i apl; Syllabuset e lëndëve; RVB, fq. 18; Takimi me stafin akademik</i>).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit organizohet sipas strukturës së nevojshme për një program studimi të ciklit të dytë. Plani mësimor është i organizuar sipas komponentëve të nevojshëm. Megjithatë, programi i studimit është përballur me sfida për t'u përshtatur me nevojat e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush kryesisht kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit MND ofron kompetenca teorike dhe metodologjike dhe aftësi të kërkimit shkencor në shumë drejtimet e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci, veçanërisht në aspekte të cilat kanë të bëjnë me njohjen, kuptimin dhe analizën e politikave ndërkombëtare. Të gjithë këta elementë ndihmojnë në zhvillimin e ekspertizës në profile specifike të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci dhe në avancimit në karrierrë profesionale ose vazhdimësinë e programe studimore të mëtejshme, por edhe për tu përballur me tregun e punës. Në përfundim të programit të studimit, studenti mund të ushtrojë një llojshmëri profesionale dhe specialitetesh si nëpunës i administratës publike dhe shërbimeve diplomatike, punonjës në organizata ndërkombëtare dhe jo qeveritare, ekspert në institucionet e Bashkimit Evropian, fondacione, akademi, institute

	<p>të edukimit, organiza biznesi, dhe media, si dhe vazhdimin e një karriere akademike (lektor, kërkues shkencor etj.) (Ref. Evidencë 20. Studim për perceptimin e studentëve mbi tregun e punës në profilin marrëdhënie ndërkombëtare; Evidencë 41. Formular për gjurmimin e Alumnit; Evidencë 29. Pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orjentimin e tyre në tregun e punës; RVB, fq. 18-19; Takimet me studentët e programit të studimit dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumnit).</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar më konkretisht në Planin Mësimor, janë ndërtuar për të mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 2 vite akademike dhe realizohen me 120 kredite. Masteri është strukturuar në dy semestra, me nga 30 kredite secili. Lëndët janë të formimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. Nga natyra programi është i balancuar dhe arrin objektivat formuese. Përveç lëndëve bazë, ofrohen edhe njohuri të thelluara, duke siguruar një përgatitje të mirë në disa drejtime kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. Programi i studimit, gjithashtu ofron kompetenca shtesë të specializimit në çështjet e rajoneve të ndryshme, si dhe mundëson aftësimin për kërkim shkencor të pavarur. Ngarkesa e programit të studimit është ndërtuar sipas legjislacionit evropian dhe atij shqiptar të arsimit, dhe është e përshtatshme për nivelin 7 në kornizën kombëtare dhe Evropiane të kualifikimeve. Rëndësia e lëndëve metodologjike si dhe ngarkesë në Tezën e Diplomës i aftëson dhe përgatit studentët për vijueshmërinë e mëtejshëm në studime të ciklit të tretë, doktoraturës (Ref. Evidencë 24.1. Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; RVB, fq. 19).</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në bazë të kriterëve dhe standarteve të ciklit të dytë të studimeve duke kombinuar lëndë të formimit metodologjik bazë, grup-lëndësh karakterizuese dhe me zgjedhje, praktikë profesionale dhe kërkim shkencor të pavarur. Ky program studimi është në përputhje me programet të ngjashme dhe praktikat të mira kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen nëpër universitetet të ndryshme (Ref. Evidencë 24.1. Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; RVB, fq. 19).</p>

<p>“Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja e ngarkesës është relativisht e përshtatshme për këtë program studimi, ndonëse vërehet një theks i veçantë në aspektet empirike të rajoneve të ndryshme të botës se sa te teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të diplomacisë. Në këtë master ze peshë më shumë formimi empirik se sa ai teorik. Aspekti pozitiv është se disa prej lëndëve kanë orientim të fortë empirik gjë që plotëson praktikën. Kjo ka lehtësuar nevojat e studentëve për punësim dhe promovim në vendet e tyre të punës. Megjithatë, kuptimi i konceptit dhe zhvillimit të mobilitetit është i kufizuar brenda institucionit pasi studentët përballen me sfida në njohjen e kurseve të ndjekura në mobilitet (<i>Ref. Evidencë 24.1. Plani mësimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; Evidencë 50. Praktikë për procesin e transferimeve; RVB, fq. 19; Takimet te institucioni</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programi i studimit është në gjuhën shqipe, por shumë nga detyrat e lëndëve bëhen me literaturë në gjuhën angleze, e cila mundëson përdorimin e literaturës të përditësuar nga autorët dhe shtëpi botuese akademike ndërkombëtare. Programet e lëndëve mbështeten në kombinimin e literaturës dhe leksioneve të shkruara nga pedagogët. Po kështu në syllabuse literature e detyrueshme është edhe në gjuhë të huaj, anglisht. Ndërsa syllabuset përditësohen çdo vit, pjesa e literaturës së syllabuseve kërkon vëmendje të veçantë, veçanërisht për sa i përket viteve të botimit të literaturës (<i>Ref. Evidencë 27. Syllabuset në Master i Shkencave Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, formulari i apl; Syllabuset e lëndëve; RVB, fq. 20; Takimi me stafin akademik të programit të studimit</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit, garanton cilësinë dhe përfitimin e dijeve dhe kompetencave të synuara në këtë program të ciklit të dytë të studimeve. Synimi i programit lidhet ngushtë me përgatitjen profesionale të studentit dhe nevojat e sektorit publik. Programi i studimit lejon specializimin e thelluar të studentit në dy drejtime kryesore të shkencave politike, atë të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë. Programi ofron njohuri metodologjike, si aftësi dhe njohuri për të aplikuar në mënyrë</p>



	kritike instrumentet metodologjike të kërkimit, duke përfshirë aftësinë për të planifikuar dhe kryer hulumtime të pavarura (Ref. Evidencë 130. Aplikimi i Masterit Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; RVB, fq. 20; Takimet me stafin akademik, me studentët e programit të studimit dhe me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit pajis studentët me aftësi dhe kompetanca profesionale në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci, me profilizim në fusha specifike si dhe çështje aktuale rajonale dhe globale e cila mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës (Ref. Evidencë 29. Pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orjentimin e tyre në tregun e punës; Evidencë 131. Databazë punësimesh Alumni; RVB, fq. 20; Takimet me stafin akademik, me studentët e programit të studimit dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumnit).			
Konkluzione	Programi i studimit përmban elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara te Kuadri Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Ndarja e ngarkesës është relativisht e përshtatshme për këtë program studimi, ndonëse vërehet një theks i veçantë në aspektet empirike. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse	Programi mbështetet në analizat e përgjithshme nga njësia bazë DSHP që përmbajnë aspekte të analizës së tregut të punës. Në këta analiza përmenden intervistat me aktorët e interesuar të cilët japin mendimin e tyre për programet e studimit. Megjithatë, njësitë përgjegjëse nuk kanë kryer një analizë të veçantë të tregut të punës për qëllimet e programit të studimit MND. Mungon një analizë e tregut të punës, e cila do të ndihmonte për përshtatjen më të mirë të

<p>konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>programit të studimit me kërkesat e tregut e punës, për përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, për të ndërmarr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit dhe për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter praktik dhe kërkesat e tregut të punës (Ref. Evidencë 20. Studim për perceptimin e studentëve mbi tregun e punës në profilin marrëdhënie ndërkombëtare; Evidencë 29. Pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orjentimin e tyre në tregun e punës; RVB, fq. 20-21; Takimet me stafin akademik dhe me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni UAMD synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit si dhe sigurimin e përfshirjes së studentëve më të dalluar në aktivitetet e departamenteve, punën kërkimor-shkencor, konferencat dhe workshopet. Zyra e Alumnit e institucionit mban kontakte me studentët e diplomuar. Megjithatë, nuk ka ndonjë praktikë konkrete dhe të veçantë të përfshirjes së studentëve dhe strukturave të tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit MND (Ref. Evidencë 28. Buletini i aktiviteteve FSHPJ 2021-2022; Evidencë 64. Leksion i hapur në DSHP; Evidencë 112. Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet; RVB, fq. 21 Takimet me studentët e programit të studimit dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumnit).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Për programin e studimit MND, DSHP bashkëpunon me institucionet partnere, me sektorin publik si dhe me sektorin privat në rast përditësimi, përshtatje dhe riorganizimi të programit të studimit. Praktikë konkrete të bashkëpunimit me palët e interesuara ishte riorganizimi i këtij programi studimi nga “Gjeopolitika dhe Sistemet e Sigurisë” në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” në vitin 2019 (Ref. Evidencë 5. Pani Strategjik i Zhvillimit të masterit shkencor MND; RVB, fq. 21; Takimi me stafin akademik).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ekziston një kornizë për përfshirjen e studentëve në nivele të ndryshme të punës së institucionit, duke përfshirë edhe këtë program studimi. Megjithatë, mungon një studim specifik i fundit i tregut të punës që lidhet me programin e studimit MND. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush kryesisht kërkesat e standardit.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit MND ka si prioritet kryesor ofrimin e një diplome në marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci në përputhje kjo me misionin dhe qëllimin e IAL-së, dhe aftësimi dhe edukimi i profesionistëve të ardhshëm të politikës ndërkombëtare me njohuri bashkëkohore që t'i përgjigjen kushteve të reja të zhvillimit të kontekstit kombëtar, rajonal e global. Megjithatë, prioritetet e kërkimit shkencor te njësia bazë nuk janë identifikuar në mënyrë eksplicite (<i>Ref. Evidencë 5. Pani Strategjik i Zhvillimit te masterit shkencor MND; Evidencë 2.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Evidencë 49. Strategjia e Zhvillimit, FSHPJ 2020-2025; Evidencë 52. Përmbledhëse e kërkimit shkencor, FSHPJ 2021-2022; Evidencë 118. Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore; RVB, fq. 22</i>).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia bazë, në bashkëpunim me njësitë të IAL-së, garantojnë dhe mundësojnë liritë akademike të personelit, duke u bazuar në parimet dhe praktikat më të mira të arsimit evropian (<i>Ref. Evidencë 105. Monitorimi i procesit mësimor; RVB, fq. 22; Takimi me stafin akademik</i>).
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit mundëson dhe nxit studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. Praktikë e mirë ka qenë organizimi i konferencave akademike për studentët ku studentët e programit të studimit MND patën mundësi të prezantojnë hulumtimet e tyre (<i>Ref. Evidencë 78. Projekt në FSHPJ; Evidencë 139. Shembull angazhimi i studenteve MSH viti II; Evidencë 33. Thirrja e Konferencës Studentore, FSHPJ 2023; RVB, fq. 22; Takimi me studentët e programit të studimit</i>).
Kriteri 4. Për realizimin e	Për kërkimin shkencor, institucioni ofron lloje të ndryshme

<p>aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>stimujsh për stafin akademik që të përfshihen në kërkimin shkencor dhe në aktivitete të ndryshme studimore. Gjithashtu, kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet fondit institucional për financimin e publikimeve në revista ndërkombëtare. Megjithatë, financimi nuk është shpërblim për botim, por rimbursim i kostove për pagesën e tarifës për botimin e një artikulli në revistë, e cila nuk nxit publikimin në revistat me faktor impakti (Ref. Evidencë 118. Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore; Evidencë 59. Konferenca e VI-te Shkencore Nderkombetare, FSHPJ, Prill, 2022; Evidencë 149. FSHPJ organizoi konferencen e 7-te shkencore - Universiteti Aleksandër Moisiu; Evidencë 147. Mbi kërkesat buxhetore për vitin 2023 FSHPJ; RVB, fq. 22; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP dhe me përfaqësues të zyrës së projekteve).</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit mundëson dhe nxit studentët dhe pedagogët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Megjithatë, mungon një orientim i qartë për stafin akademik të programit të studimit në përfshirjen e tyre në kërkimin akademik dhe publikime. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush kryesisht kërkesat e standardit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Institucioni dhe njësitë përgjegjëse japin hapësirë për angazhim në kërkime shkencore nëpërmjet skemës së saj të financimit dhe nëpërmjet projekteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të ndërmjetësuar nga Drejtoria e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë. Megjithatë, mungon një mjedis kërkimor që do të stimulonte përfshirjen e mëtejshme të stafit akademik në kërkime për tema që i afrohen më shumë kontekstit gjeografik të vendndodhjes së UAMD (Ref. Evidencë 43. Fushat e Kërkimit Shkencor FSHPJ; Evidencë 43.1 Grupet Mesimore kërkimore DSHP; Evidencë 77. Shembuj Thirrje për Trajnime dhe</p>

	<i>Pjesëmarrje në Projekte; Evidencë 160. Praktika të mbështetjes financiare në konferenca të stafit; RVB, fq. 23; Takimet me stafin akademik dhe me përfaqësues të zyrës së projekteve).</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Institucioni dhe njësitë përgjegjëse si dhe Drejtoria e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë informojnë stafin akademik dhe studentët për thirrjet dhe kërkesat për kryerjen e studimeve dhe analizave dhe i inkurajon ata të aplikojnë (Ref. Evidencë 118. Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore; Evidencë 157. Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Botimeve; RVB, fq. 23; Takimet me stafin akademik dhe me përfaqësues të zyrës së projekteve).
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Institucioni dhe njësitë përgjegjëse organizojnë konferenca të ndryshme, siç është konferenca vjetore akademike e organizuar nga FSHPJ, në të cilën personeli akademik dhe studentët marrin pjesë me prezantimet e tyre. Megjithatë, është koha që DSHP të shkojë përtej organizimit të konferencave dhe të zgjerojë infrastrukturën e saj për kërkime duke nxjerrë në treg revistën e saj akademike që do të jetë e hapur si për anëtarët e stafit dhe studentët e tij, ashtu edhe për jashtë. Hapësira të reja shkencore mund të përdoren nga pedagogë dhe studentë të programit për të organizuar edicione specifike me tematika me interes për programin e studimit dhe me përfshirjen edhe të pedagogëve dhe studentëve të universiteteve partnere (Ref. Evidencë 33. Thirrja e Konferencës Studentore, FSHPJ 2023; Evidencë 59. Konferenca e VI-te Shkencore Nderkombetare, FSHPJ, Prill, 2022; Evidencë 149. FSHPJ organizoi konferencën e 7-te shkencore - Universiteti Aleksandër Moisiu; Evidencë 79. Forume, Seminare dhe Workshop-e akademike të organizuara në UAMD; RVB, fq. 23; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, me stafin akademik dhe me përfaqësues të zyrës së projekteve).
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit ka mundur të kontribuojë në formimin e kuadrit të ri të profesionistëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci që vijnë nga qarku i Durrësit dhe më gjerë. Kontributi i tij specifik ka qenë përgjigja e saj ndaj kërkesës në rritje si nga sektori publik ashtu edhe ai privat në qarkun e Durrësit për punësimin e profesionistëve të fushës (Ref. Evidencë 131. Databazë punësimesh Alumni; RVB, fq. 23-24; Takimet me studentët e programit të studimit).

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<i>Nuk aplikohet.</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	<i>Nuk aplikohet.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka mundur specializimin e studentëve dhe të stafit akademik, duke përfshirë edhe kërkimin akademik. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.
--



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Përveç formave tradicionale të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet leksioneve, transmetimi i dijeve e njohurive bëhet edhe nëpërmjet seminareve, detyrave të kursit, orëve të hapura, praktikat profesionale, dhe supervizimi i punimit të diplomës. Studentëve u kërkohen në bazë të lëndëve të realizojnë edhe projekte të përbashkëta e punë në grup. Fakti është se kjo mbetet në autonominë e pedagogut i cili orienton dhe organizon mësimin sipas kurrikulës dhe praktikave më të mira të institucionit. Përmes projektit të tezës të masterit (mikroteza), e cila ka një numër të konsiderueshëm orësh dhe 18 kredite (ECTS), studentët kryejnë punë kërkimore të pavarur nën udhëheqjen e pedagogëve duke dëshmuar se kanë fituar aftësinë për të kryer kërkime të pavarura akademike. Megjithatë, emërtimi i tezës përfundimtare si "mikrotezë" nuk pasqyron seriozitetin që i kushton një program i masterit i shkencave tezës përfundimtare (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; Evidencë 24.1. Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; RVB, fq. 24-25; Takimet me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Zhvillimi i orëve të leksionit bëhet edhe nëpërmjet metodave interaktive dhe diskutimeve, dhe ekspertëve të ftuar që e bëjnë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive. Diskutimet në orën e seminarit dhe leksionit, dhe prezantimet i japin mundësi studentit të bëjë analiza dhe të shprehë mendimin e tij në mënyrë të pavarur. Inkurajohet edhe organizimi i seminareve me ekspertë të ftuar në lidhje me çështje të ekspertizës së tyre sipas tematikave të leksioneve. Gjithashtu, IAL-ja është i detyruar të zbatojë parimet e ligjeve jo-diskriminuese vendase dhe politikave të diskriminimit pozitiv. UAMD ka një rregullore për studentët me aftësi të kufizuara. IAL-ja angazhohet që studentët me nevoja të veçanta dhe/ose me sëmundje kronike nuk do të jenë subjekt i asnjë forme diskriminimi (Ref. RVB, fq. 25; Takimet me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni</p>	<p>IAL-ja mundëson përmirësimin e kompetencave pedagogjike të</p>

<p>mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>stafit akademik përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme të organizuara për këtë qëllim. Auditorët janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, të cilat lehtësojnë përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. Në kuadër të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, personeli akademik i programit të studimit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh në universitetet partnere evropiane. Gjithashtu, përmes programeve të shkëmbit Erasmus+ personeli akademik ka patur mundësi të japë mësim dhe të përfitojë eksperiencë në universitetet partnere. Megjithatë, ka mungesë të orientimeve të qarta për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie dhe për këtë arsye, stafi akademik më së shumti kufizohet me mësimdhënie në leksione nga tre orëshe javore, gjë që nuk ofron ndonjë fleksibilitet të madh për përdorimin e metodave inovative (<i>Ref. Evidencë 58. Të dhënat mbi mobilitetet; Evidencë 2.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; RVB, fq. 25; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, me studentët dhe me stafin akademik të programit të studimit</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojë akademike dhe profesionale në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndëve që zhvillojnë. Eksperienca brenda dhe jashtë institucionit, trajnimet e ndryshme dhe publikimet bëjnë të mundur që personeli akademik i angazhuar në programin e studimit të jetë kompetent në lëndën që zhvillon dhe në metoda didaktike që përdor. Një prej elementëve që programi inkurajon është të menduarit kritik dhe aftësimi të studentit të veprojë me autonomi në zgjidhjen e problemeve me të cilat ata përballen. Për këtë ata gjejnë mbështetje nga mësimdhënësit. Në takimin e GVJ-së me studentët e programit të studimit, studentët janë shprehur të kënaqur për hapësirën e ofruar për diskutime dhe mendim kritik. Megjithatë, metodat që përdoren nuk gjenden të përfshira në syllabuset e programit të studimit. Ndërsa syllabuset mbulojnë përmbajtjen e një lënde, në shumë syllabuse të programit të studimit mungon informacioni për metodat e përdorura për qëllime të mësimdhënies (<i>Ref. Evidencë 129. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme; RVB, fq. 25-26; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, me studentët dhe me stafin</i></p>

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p><i>ad akademik të programit të studimit).</i></p> <p>Një nga format e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes pyetësorëve të studentëve që kryhen në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimat e tyre. Mendimet e studentëve reflektohen në pyetësor i cili administrohet nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Standarteve të Cilësisë. Rezultatet e përmbledhura të këtyre vlerësimeve u bëhen me dije nga ana e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrimeve personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të format e metodat e mësimdhënies. Më pas rezultatet e vlerësimeve diskutohen në nivel departamenti. Sugjerimet e studentëve gjejnë vend e më pas reflektohen në programin e studimit. Gjithashtu, studentët shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre gjatë orëve të mësimi dhe në komunikimet dhe takimet e tyre me stafin akademik të departamentit, si dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Megjithatë, këto mjete për marrjen parasysh të pikëpamjeve të studentëve mund të konsiderohen si të kufizuara. Ato mund të zgjerohen edhe me organizimin e fokus grupeve me studentët të cilat mund të ofrojnë mundësi shtesë të komunikimit të pikëpamjeve të studentëve në departament (<i>Ref. Evidencë 39. Formular vlerësimi nga studentët; Evidencë 83. Analiza pyetësoreve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ); Evidencë 84. Pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orjentimin e tyre në tregun e punës; RVB, fq. 26; Takimi me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë).</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë</p>	<p>UAMD posedon infrastrukturë institucionale që mbështetin përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Kjo përfshin njësitë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, - Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, - Drejtoria e Administrimit dhe e Shërbimeve Akademike, - Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme. <p>Këta njësi janë në bashkëpunim të vazhdueshëm me njësitë kryesore dhe bazë dhe organizojnë trajnime për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Nisma më e fundit në këtë drejtim ka qenë organizimi i orëve me mjete</p>

përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	online gjatë pandemisë Covid-19. Megjithatë, kanë munguar iniciativat specifike që do të synojnë eksperimentimin me metoda inovative dhe zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie (Ref. Evidencë 63. Raport Vjetor UAMD 2021-2022; Evidencë 95. Struktura Organizative e UAMD; RVB, fq. 26-27; Takimet me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, të Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të Drejtorisë së Administrimit dhe e Shërbimeve Akademike).		
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë mundëson përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit. Përveç formave tradicionale të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet leksioneve, transmetimi i dijeve e njohurive bëhet edhe nëpërmjet seminareve, detyrave të kursit, orëve të hapura, praktikave profesionale, dhe supervizimi i punimit të diplomës. Megjithatë, mjetet si për mësimdhënie, ashtu edhe për vlerësimin e mësimdhënies mund të zgjerohen edhe me metoda të tjera inovative. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush kryesisht kërkesat e standardit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret e Universitetit, të Fakultetit dhe të Departamentit përcaktojnë kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive. Studentët njoftohen mbi këtë gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Format e vlerësimit i komunikohen studentëve nga pedagogët edhe në syllabus. Në vazhdimësi, studenti mund të informohet nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Fakulteti ose nga Departamenti (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore

	<i>e Departamentit te Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 27; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit).</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të lëndës për çdo semestër, titullari i lëndës i njëj studentët me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit te Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 27; Takimet me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit).			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Për studentët e programit të studimit MND në pjesën dërmuese përdoret forma e kontrollit të dijës të provimit me shkrim me alternativa si dhe komponentët e tjerë plotësues si pjesmarrja, detyrat e kursit dhe projektet. Komponenti më i rëndësishëm i vlerësimit mbetet provimi me shkrim, kryesisht me pyetje me alternativa (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit te Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 27-28; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit).			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka përcaktuar në procedura kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive. Studentët njoftohen mbi këtë gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, si dhe nga syllabuset dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje e notës përfundimtare. UAMD ka një strukturë që privilegjon kontrollin e vazhdueshëm të dijes gjatë vitit. Kjo reflektohet kryesisht në ndarjen e provimit të kontrollit të dijes në dy periudha, atë të ndërmjetme dhe atë përfundimtare. Forma e kontrollit është me shkrim, përmes një provimi me pyetje me alternative. Në UAMD, provimi me shkrim realizohet nëpërmjet provimit të ndërmjetëm dhe provimit përfundimtar, përkatësisht me 40% dhe 50% të peshës. Pjesa e mbetur prej 10% vlerësohet në bazë të detyrës së projektit. Nota kaluese më e ulët është nota pesë, e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara, ndërsa nota më e lartë shkëlqyeshëm është dhjetë me 94% (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 28).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UAMD ka përdorur historikisht formën e testimit me shkrim, provim me pyetje me alternativa. Përpara provimit, pedagogu depoziton çelësat me përgjigjet e duhura. Kontrolli i tyre bëhen manual sipas çelësit. Kohët e fundit, në vlerësimin e njohurive të lëndës, UAMD po shfrytëzon projektin Clean Score, korrigjimin elektronik të provimeve. Ky sistem elektronik ka përmirësuar testimin dhe vlerësimin pasi ajo e perjashton pedagogun nga korrigjimi të cilin e kryen sistemi (Ref. Evidencë 75. Marrëveshje Bashkëpunimi AADF; RVB, fq. 28; Takimi me stafin akademik).</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet nga titullari i lëndës. Procesverbali final mban firmën e pedagogut, shefit të departamentit, kryesekretares dhe dekanit (Ref. RVB, fq. 28; Vizitë në Sekretarinë Mësimore).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të</p>	<p>Ndonëse nuk është sistematike, ata studentë që dëshirojnë ta bëjnë këtë, mund të bisedojnë me pedagogët e tyre për të kuptuar më mirë pikat e tyre të forta dhe për të identifikuar dobësitë në procesin e të mësuarit (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë</p>

<p>nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 28; Vizitë në Sekretarinë Mësimore).</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Kopjimi dhe plagjatura nuk tolerohet. Provimet po monitorohen nga të paktën dy pedagogë, të cilët caktohen nga departamenti për këtë qëllim. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur. Po ashtu bëhen përpjekje për të shmangur plagjaturën kur studentët dorëzojnë projekte, ese ose teza përfunduese për diplomën master. Megjithatë, nuk del në pah përdorimi i ndonjë platforme specifike që e evidenton plagjaturën (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 29; Takimi me stafin akademik).</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rregullorja kushtëzon pedagogët që të japin rezultatet e vlerësimeve të tyre brenda 72 orëve nga data e mbajtjes së provimit. Gjithashtu, struktura e vendosur, në parim, siguron respektimin e vlerësimit të bazuar në merita. Megjithatë, gjatë bisedimeve të GVJ-së në institucion, janë vërejtur situata ku pedagogët udhëhiqen nga vlerësimet e tyre në të kaluarën, në vend që të fokusohen në rezultatet e arritura në mënyrë specifike nga një provim apo detyrë e caktuar (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 29; Takimet te institucioni).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijës bëhen publike sikurse e përcakton dhe rregullorja. Pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. Studentët kanë të drejtë të ankohen brenda 72 orëve nga shpallja e rezultateve e provimit (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 29).</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga</p>	<p>Ekziston një procedurë ankimimi nga studenti për vlerësimin, e cila vlerësohet nga një komision i ngritur posaçërisht. Ky</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

35

komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	komision në bazë të kërkesës procedon me ballafaqimin e testit me çelësin. Kjo procedurë parashikohet në rregulloret e UAMD, Fakultetit dhe Departamentit (Ref. Evidencë 6.1. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 8. Rregullore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidencë 9. Rregullorja e masterit; RVB, fq. 29).			
Konkluzione	Institucioni ka një strukturë që siguron kontrollin e vazhdueshëm të dijes gjatë vitit. Forma kryesore e testimit është me shkrim, provim me pyetje me alternativa. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit i lejon studentit që të krijojë profilin e tij akademik duke zgjedhur në mënyrë të pavarur kurse me zgjedhje të cilat i krijojnë mundësi për studime të thelluar në fushat respektive. Kurset bazë, e avancuar dhe ndërdisiplinore u japin studentëve orientimin e nevojshëm. Kjo mënyrë organizimi ndihmon studentët të kryejnë në mënyrë të pavarur kërkim shkencor dhe të zhvillojnë strategji kërkimore, të thellojë njohuritë për zhvillimin e aftësitë profesionale dhe të veçanta. Studentët janë gjithashtu të angazhuar në aktivitete të ndryshme kërkimore dhe shkencore që i ndihmojnë ata të thellojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre (Ref. Evidencë 24. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)-Master MN&D 16'-20'; Evidencë 24.1 Plani mesimor 20'-22' dhe Syllabuse DSHP; Evidencë 33. Thirrja e Konferencës Studentore, FSHPJ 2023; Evidencë 28. Buletini i aktiviteteve FSHPJ 2021-2022; RVB, fq. 30; Takimet të institucioni).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e	Programi i studimit MND ofron zhvillimin e aftësive në fushën specifike të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci. Aftësitë e veçanta orientohen kah zhvillimit të kapaciteteve

<p>teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>organizative dhe analitike të studentëve dhe formimin e tyre duke patur parasysh praktikat më të mira. Studenti fiton aftësi organizative, aftësi komunikimi, si dhe zgjeron perspektivën në fushën studimore dhe atë sociale (Ref. Evidencë 28. Buletini i aktiviteteve FSHPJ 2021-2022; RVB, fq. 30; Takimi me studentët e programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Si rregull, në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu eseja apo detyra e kursit që zhvillohen janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda. Syllabuset përmbajnë komponentë shtesë përveç atyre që kanë të bëjnë me qëllimin e lëndës dhe programin. Në to shpjegohen dhe analizohen pritshmëritë e pedagogëve mbi kompetencat dhe aftësitë që studentët duhet të përftojnë në fund të lëndës (Ref. Syllabuset e lëndëve; RVB, fq. 30; Takimi me stafin akademik).</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila ndihmon në rritjen e aftësive profesionale dhe integrimin më të mirë në tregun e punës. Ndërkohë që ka ndërlidhje mes lëndëve dhe praktikës profesionale, kjo e fundit po zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve, gjë që nuk lejon reflektime të mëtejshme mbi rezultatet e praktikës me të nxënit në kuadër të lëndëve. Lektorët duket se inkurajojnë diskutimet në klasë dhe u japin hapësirë studentëve për të reflektuar mbi pikëpamjet dhe analizat e tyre. Bashkëpunimi i krijuar me aktorë të ndryshëm si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat u jep mundësi studentëve të vendosin kauzalitet ndërmjet të nxënit të tyre teorik në klasë me atë që vëzhgojnë në realitet. Te detyrat e lëndëve studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Një prej komponentëve të vlerësimit të studentëve është dhe puna në grup që studentët mund të zhvillojnë gjatë studimeve. Personeli akademik inkurajon punën në grup nëpërmjet hulumtimit të një rasti studimor, planifikimin dhe zbatimin e një projekti (Ref. Evidencë 45. Marrëveshjet e bashkëpunimit FSHPJ; RVB, fq. 30-31; Takimet me studentët dhe me stafin akademik).</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor, për të informuar kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit të disiplinave dhe fushave të tyre të studimit. Gjithashtu, konferenca shkencore dhe aktivitete jashtë kurrikulare organizohen që janë të hapura për studentët (Ref. Evidencë 28. Buletini i aktiviteteve FSHPJ 2021-2022; Evidencë 42. Raport Vjetor UAMD 2020-2021 (Aktiviteti Kërkimor); RVB, fq. 31; Takimet me studentët dhe me stafin akademik).</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Njësia bazë organizon aktivitete të veçanta si vizita studimore pranë institucioneve të ndryshme apo përfshirjen në projekte të studentëve. Personeli akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore në kuadër të projekteve apo grupeve kërkimore të organizuara në nivel Departamenti dhe Fakulteti. Studentët marrin pjesë edhe në projektet apo marrëveshjet e shkëmbimit Erasmus +. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë skemë financiare që i përket institucionit që synon pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet kërkimore. Gjithashtu, qëndrimi konservator i departamentit dhe stafit akademik ndaj aspekteve të mobilitetit i ka dekurajuar studentët që të përfitojnë nga mundësitë e lëvizshmërisë në kuptimin e kërkimit shkencor (Ref. Evidencë 63. Raport Vjetor UAMD 2021-2022; Evidencë 64. Leksion i hapur në DSHP; Evidencë 161. Vendim për grupet e punës në Konferencën e FSHPJ 2023; Evidencë 58. Të dhënat mbi mobilitetet; Evidencë 33. Thirrja e Konferencës Studentore, FSHPJ 2023; RVB, fq. 31; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, me studentët dhe me stafin akademik).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit i lejon studentit mundësi për studime të thelluar në fushat respektive dhe për zhvillimin e aftësitë profesionale dhe të veçanta. Studentët janë gjithashtu të angazhuar në aktivitete të ndryshme kërkimore dhe shkencore. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush plotësisht kërkesat e standardit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43428

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

38



programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar një procedurë të tillë. Procedura dhe rezultatet bëhen publike. “Mikro-Teza” është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. Megjithatë, emërtimi i tezës përmbyllëse si Mikrotezë është problematik duke pasur parasysh rëndësinë që ka një tezë në studimet Master Shkencor (<i>Ref. Evidencë 15.1 Udhëzues Diplomimi Master DSHP; Evidencë 12. Rregullore diplomimi; RVB, fq. 32</i>).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti ka hartuar një paketë me udhëzime për mikrotezën. Sipas kësaj çdo student ndiqet nga pedagogu përkatës, i cili përzgjidhet nga studentët ose caktohet kryesisht nga Departamenti. Studenti udhëhiqet nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit të studentit. Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera dhe komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës (<i>Ref. Evidencë 14.1. Rregullore e tezës. MND; RVB, fq. 32; Takimet me studentët dhe me stafin akademik</i>).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<i>Nuk aplikohet.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe	Studentit i ofrohet nga departamenti një paketë orientuese mbi procedurën, stilin dhe mënyrën e paraqitjes së temës. Studentët propozojnë pedagogun dhe temën që duan të zhvillojnë në përputhje me interesat e tyre. Megjithatë, nga bisedimet e GVJ-së në institucion, është vërejtur se ka një shpërndarje të pabalancuar të përgjegjësisë të mbikëqyrjes së tezave të masterit të studentëve. Shpesh studentët zgjedhin 1 ose 2 pedagogë si mbikëqyrës të tyre (<i>Ref. Evidencë 12. Rregullore diplomimi;</i>

<p>shkrimin e punimit përmyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i>Evidencë 14. Struktura e Mikrotezës MND; Evidencë 14.1. Rregullore e tezës. MND; Evidencë 15. Udhëzues Praktika Master DSHP 2021-2022; Evidencë 15.1. Udhëzues Diplomimi Master DSHP; RVB, fq. 32-33; Takimet me studentët dhe me stafin akademik).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni, por në mënyrë specifike mbikëqyrësit dhe drejtuesi i departamentit, i ndihmojnë studentët të kenë akses në institucione të ndryshme, veçanërisht kur ka nevojë për kryerjen e anketave (Ref. RVB, fq. 33; Takimet me drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP, me studentët dhe me stafin akademik).</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi bëhet me notë nga komisioni pas mbrojtjes së diplomës. Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos komisioni vlerësues. Studenti paraqet punën përmes një prezantimi për një sasi kohe të caktuar. Në bazë të performancës dhe indikacioneve të tjera, komisioni vendos për notën (Ref. Evidencë 12. Rregullore diplomimi; Evidencë 14. Struktura e Mikrotezës MND; Evidencë 15.1 Udhëzues Diplomimi Master DSHP; RVB, fq. 33).</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të shlyerjeve akademike, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratura nga ministria përgjegjëse për arsimin. Me kërkesë të vetë studentit, ai mund të marrë një kopje zyrtare të silabuseve të programit të studimit të zhvilluar (Ref. Evidencë 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidencë 11. Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore FSHPJ; Evidencë 12. Rregullore diplomimi; Evidencë 17. Rregullore për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD; RVB, fq. 33; Vizitë në Sekretarinë Mësimore).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni ruan dokumentacionin dhe i përgjigjet studentëve kur këta e kanë të nevojshme duke i vënë në dispozicion informacionet e nevojshme. Studentët pajisen me dokumentat përkatëse sikurse parashikon ligji. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion u evidentua mungesa e regjistrimit përkatës për masterin. Sipas sekretarisë me gjithë kërkesat e vazhdueshme studentët nuk janë të regjistruar në regjister. Gjithsesi, institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve i cili siguron mbrojtjen e nevojshme të të dhënave</p>

	përkatëse (Ref. Evidencë 11. Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore FSHPJ; Evidencë 17. Rregullore për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD; RVB, fq. 33; Vizitë në Sekretarinë Mësimore).		
Konkluzione	Institucioni ka hartuar procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. "Mikro-Teza" është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij. Megjithatë, emërtimi i tezës përmbyllëse si Mikrotezë është problematik duke pasur parasysh rëndësinë që ka një tezë në studimet Master Shkencor. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion u evidentua mungesa e regjistrimit përkatës për masterin. GVJ është i mendimit se programi i studimit përmbush kryesisht kërkesat e standardit.		
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<i>Nuk aplikohet.</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të	<i>Nuk aplikohet.</i>

njohurive dhe kompetencave profesionale.									
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	<i>Nuk aplikohet.</i>								
Konkluzione	<i>Standardi nuk aplikohet për këtë program.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	-	-	-	-
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
-	-	-	-						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve	GVJ vlerëson se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci", të Departamentit të Shkencave Politike, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Ata përmbushin kërkesën ligjore që stafi i angazhuar duhet të ketë një nivel kualifikimi më të lartë se cikli i studimeve ku angazhohen në mësimdhënie. Në vitin akademik 2018-2019 është vetëm viti I i Masterit të riorganizuar dhe riemërtuar si "Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci" që ka pasur 5 PAE (nga të cilët 4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

42

Mona Berri

<p>mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>të kategorisë Profesor, vetëm një Dr.) dhe 4 PAK (Dr.). Ndërsa në vitin akademik 2019-2020, ky raport ndryshon ku PAE zë një peshë më të madhe, prej në 9 PAE, ku shtohen 4 Dr., kurse PAK mbetem po 4 Dr. <i>(Evidencë 65. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit Master Shkencor MND)</i>. Ky vlerësim bazohet në shqyrtimin e dosjeve të personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në takimin e drejtpërdrejtë me stafin e Departamentit në UAMD, në total 18 vetë PAE, ku pedagogët e lëndëve janë të gjithë me gradën shkencore Dr. (11) dhe të kategorisë profesor (2 Prof.Dr dhe 5 Prof.Assoc.Dr.). Stafi akademik efektiv mbulon nga 2-3 lëndë mësimore në Departament të cilat u sigurojnë maksimumi 135 orë mësimore. Po këto lëndë i zhvillojnë edhe në departamente të tjera për të rritur ngarkesën mësimore. <i>(Evidencë 66. Ngarkesa e stafit DSHP 2019-2022)</i>. Fusha akademike e tyre është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një eksperiencë disavjeçare edhe në fushën kërkimore siç vërtetohet edhe nga shqyrtimi që GVJ u bëri CV akademike të tyre. Ata kanë botime, grupe kërkimore e shkencore sipas fushave specifike që mbulojnë.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me Udhëzimi Nr.29 datë 10.9.2018 të MAS, si edhe në Rregulloren e Re të UAMD (Neni 107), duke respektuar kriterin e numrit të lëndëve (tre) dhe normës mësimore. Referuar Evidencës nr.66, vetëm 1 PAE mbulon 3 lëndë, shumica kanë 1-2 lëndë mesimore në Departamentin e Shkencave Politike, por që japin edhe në departamentet e tjera, pasi në këtë mënyrë plotësohet ngarkesa e ulët me 45-95 orë në DSHP. Kurse lëndët e programit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” mbulohen mbi 90% nga personeli akademik efektiv i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, apo të tjerë staf efektiv të angazhuar në mësimdhënie në UAMD. Niveli i kualifikimit dhe fushat akademike-kërkimore të tyre i përgjigjen natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë. <i>(Evidenca Nr.6 Rregullore e Re UAMD; Evidenca Nr.57 Udhëzimi për ngarkesën mësimore; Evidenca Nr 66 Ngarkesa mësimore 2019-2022)</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë</p>	<p>GVJ në takimin me burimet njerëzore dhe bisedën me stafin akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme në UAMD konstatoi</p>

<p>qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>se personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij program studimi kanë një angazhim disavjeçar në kurset përkatëse, dhe drejtuesi i Departamentit ka gati 10 vjet si personel akademik efektiv në UAMD duke kaluar shkallët e karrierës nga asistent lektor, arrin gradën shkencore Doktor e së fundmi fiton titullin profesor i asociuar. Po në karrierë në ngjitje kanë qenë edhe pjesa tjetër e stafit akademik që tregon qendrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. Kontratat e punësimit ishin sipas kërkesave të Kodit të Punës duke mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të gjithë (<i>Evidenca Nr.32 CV e Stafit Akademik në MSH MND</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik efektiv dhe joefektiv i përfshirë në këtë program studimi në pjesën më të madhe të tyre kanë një përvojë të gjatë pune në këtë drejtim, përtej periudhës së akreditimit, që tregon për vlerësimin pozitiv të tyre. Takimi i GVJ me stafin akademik provoi se ata janë titullarë të moduleve, lëndëve në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre dhe përmbajtjen e programit të studimit Master shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Nga takimi i GVJ me njësinë e Burimeve Njerëzore në UAMD, na u vu në dispozicion CV akademike e tyre dhe kontratat e punës, si dhe procedurat standard të rekrutimi dhe vlerësimit. Ato provuan se UAMD mbështetet në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit, procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe jo efektiv në përputhje me aktet ligjore, Rregulloren dhe Statutin e UAMD. Një sugjerim nga bisedat në UAMD ishte që afati prej 10 ditësh për rekrutimin e stafit joefektiv të rritet dhe të reduktohen dokumentet burokratike për ta si libreza shëndetësore, etj. (<i>Evidenca Nr.143 Memo përgj dep mbi kriteret për rekrutim; Evidenca Nr.54 FSHPS Staff akademik 2019-2020; Evidenca Nr.6 Rregullore e Re UAMD; Evidenca Nr.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.154 Procedura dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit në UAMD; Evidenca 108, Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në UAMD konstatoi se personeli ndihmës akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi ka</p>

<p>personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>nivelin e duhur të kualifikimit sipas përcaktimeve të Rregullores së programit të studimit dhe përbushin me korrektësi dhe etikë detyrimet e tyre. Për natyrën e programit të studimit Master shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”, për realizimin e tij nuk ka nevojë për orë laboratorike apo për mjedise të tjera specifike mësimore. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike ka në dispozicion auditorë bashkëkohorë te nevojshëm për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të këtij programi studimi (<i>Evidenca Nr.97 Përmbledhëse kapaciteti i UAMD; Evidenca Nr.87 Strategjia e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit 2020-2025; Evidenca Nr.96 Dokumentacion mbi asetet, objektet, pasuritë e IAL dhe politika e pronës</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Statistikat mbledhen dhe përpunohen periodikisht çdo vit akademik nga Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike dhe raportohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në formë elektronike dhe në hardcopy. Këto të dhëna përfshijnë statistikën mbi personelin akademik efektiv dhe jo-efektiv, ndihmës-akademik me kohë të plotë e të pjesshme, personelin akademik sipas titujve dhe gradave, statistika mbi ngarkesën mësimore të personelit akademik, etj. (<i>Evidencë 117. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, si edhe Departamenti i Shkencave Politike, nënshkruajnë në mënyrë të vazhdueshme marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, bashkinë, biznese dhe organizata të shoqërisë civile për praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike të studentëve. Aktualisht UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale më 31 institucione publike, organizata dhe biznese për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Gjithashtu bazuar në projektet e stafit akademik, ato u shprehen gjatë takimit me GVJ se bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore dhe OSHC ka qenë i frutshëm.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

45

tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<i>(Evidenca_Nr.45.3 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s; Evidenca Nr.45 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca_Nr.45.1 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Shkencave Politike në UAMD; Evidencë 45.4 Memorandum Bashkëpunimi mes UAMD dhe Crystal System Group.</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve. Për programet shkencore të ciklit të dytë, një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësisht të studentëve për të realizuar, jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik si dhe të aftësive kërkimore të tyre. Një pjesë e studentëve e zhvillojnë praktikën profesionale si pjesë e projekteve ku njësitë bazë marrin pjesë, që i përgatisin studentët për zhvillimin e punëve kërkimore dhe shkrimin e punimeve shkencore. Konkretisht gjate takimit me stafin akademik ne UAMD, profesoresha E.P solli shembullin e vet në anagzhimin e disa studentëve në një projekt kerkimor që ajo drejtonte. Këto synojnë të ofrojnë njohuritë e nevojshme për studentët që synojnë të vazhdojnë formimin e tyre profesional për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve doktorale. <i>(Evidenca Nr.45 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.45.1 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Shkencave Politike në UAMD).</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush plotësisht standardet e cilësisë dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e një mësimdhënie bashkëkohore dhe të kërkimit shkencor sipas fushave të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e UAMB në kampusin e ri dhe vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike, ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit në auditore. Problematikë e ngritur nga studentët, por që është e pranishme edhe për stafet akademike dhe administrative të UAMD mbetet transporti publik i studentëve dhe stafit për shkak të mungesës së një sistemi transporti modern edhe efikas publik të asaj zone. <i>(Evidenca Nr.97 Përmbledhëse kapaciteti i UAMD; Evidenca Nr.96 Dokumentacion mbi asetet, objektet, pasuritë e IAL dhe politika e pronës).</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në mjediset ku zhvillohej mësimi nga Departamenti i Shkencave Politike dhe biseda me stafin vlerëson se mjediset mësimore si auditorët kanë disa pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit (mjete audio-vizive). Mungesa mbështetëse e pajisjeve si videoprojektoreve nëpër auditore, për të gjithë lektorët, gjatë procesit mësimor, të cilët janë të domosdoshëm në disa kurse për efektivitetin e mësimnxënies.</p> <p>Ato lehtësojnë aplikimin e metodave të interaktive në auditor, ndërveprimin me studentët duke lehtësuar zbatimin e programit <i>(Evidenca Nr.97 Përmbledhëse kapaciteti i UAMD; Evidenca Nr.96 Dokumentacion mbi asetet, objektet, pasuritë e IAL dhe politika e pronës; Evidenca Nr.87 Strategjia e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit 2020-2025).</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ konfirmon sikurse edhe më sipër se DSHP disponon një laborator të pajisur me mjete të teknologjisë për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të programit të studimit, si dhe hulumtimit individual të studentëve. Ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë/ atelie specifike.</p> <p><i>(Evidenca Nr.97 Përmbledhëse kapaciteti i UAMD; Evidenca Nr.96 Dokumentacion mbi asetet, objektet, pasuritë e IAL dhe politika e pronës; Evidenca Nr.87 Strategjia e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit 2020-2025).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së</p>	<p>UAMD siguron së paku laboratorë të teknologjisë së informacionit, ku përveç aktivitetit mësimor, për të aplikuar</p>

<p>paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>njohuritë e tyre përkatëse, departamenti organizon aktivitete ekstrakurrikulare si workshope studentore ku prezantohen punimet praktike të realizuara nga studentët në projektet e kurseve ose në punime individuale. (Evidenca 61.Buletini i aktiviteteve FSHPJ 2019; Evidenca 79 Forume, Seminare dhe Workshope të organizuara në UAMD).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>UAMD dhe veçanërisht Departamenti Shkencave Politike për të pasur bashkëpunime dypalëshe që i shërbejnë dijes, praktikës dhe realizimit të programit të studimit ka nënshkruar dhe aktualizuar shumë nga marrëveshjet me institucione qeveritare dhe joqeveritare (Evidencë 98. Raporti i Vjetor 2021-2022; Evidenca Nr.45 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca_Nr.45.1 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Shkencave Politike në UAMD).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konfirmon se UAMD disponon një kampus të ri universitar me mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit. UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit kanë nënshkruar një sërë marrëveshjes me institucione publike, biznese dhe OSHC. Problematikë mbetet transporti publik i studentëve dhe stafit për shkak të mungesës së një sistemi transporti modern edhe efikas publik të asaj zone.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Mora Berri

mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Pas shqyrtimit të syllabuseve dhe diskutimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se të gjitha lëndët e programit të studimit të ciklit dytë kanë nevojë për literatura bashkëkohore që të ndodhen fizikisht në bibliotekën e ndodhur në kampusin e ri. Nga biseda me bibliotekaren dhe shqyrtimi i fondit të librave fizike në bibliotekë, konstatuam se në vitet e fundit nuk është shtuar fondi i teksteve dhe librave fizike. Aty kishte dispenca në trajtën e leksioneve të printuara nga titullarët e lëndëve, të miratuara në Departamentin e Shkencave Politike sipas kriteve bazuar në Rregullore e Këshillit të Botimit. (<i>Evidenca Nr.51 Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD</i>).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	DSHP propozon çdo vit literatura sipas syllabuseve të programit të studimit, ndonëse vitet e fundit sidomos pas COVID 19 janë fokusuar më tepër në literaturat online dhe jo pasurimit të bibliotekës me libra fizike. (<i>Evidencë 81. Manual për bibliotekën online (drejtorja e shërbimeve akademike e informacionit) Final Rap; Evidenca 89. Raport i vetvlerësimit 2021-2022; Evidenca Nr.71 Informacion për bibliotekën online</i>).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UAMD vë në dispozicion të studentëve disa biblioteka mësimore në të gjitha godinat sipas Fakulteteve respektive, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë edhe në fundjavë. Biblioteka Nr. 3 (35 m ²), pranë godinës Nr 2, në kampusin e ri i shërben FSHP-J dhe kryesisht realizimit të këtij programi studimi. (<i>Evidenca 82. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë; Evidenca 97.5 Të dhëna të plota për infrastrukturën (Plani strategjik i Bibliotekës 2015-2020)</i>).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e	Çështja shtrohet për pasurimin e vazhdueshëm të Bibliotekës me fond fizik të viteve të fundit i cili është i kufizuar për programin e studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”, sidomos pas situatës së Pandemisë së Covid 19, që koinçidon edhe me periudhën e akreditimit të këtij programi studimi. GVJ gjatë vizitës në Bibliotekë konstatoi se ajo është e pajisur me pajisje teknologjike që mundësojnë dhe shpejtojnë kërkimin e shpejtë të literaturës fizike e digjitale. Biblioteka ka pasur prurjet e fundit me libra fizikë në vitin 2016, kurse

të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	pedagogëve ndonëse ju kërkohet të sjellin literaturat e fundit në Bibliotekë që ajo ti skanojë e t'ua vërë në dispozicion studentëve, jo gjithmonë e bëjnë këtë. <i>(Evidenca Nr.71 Informacion për bibliotekën online).</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Mjediset e bibliotekës fizike ishin të mjaftueshme për numrin e vogël të studentëve të këtij programi studimi, kurse biblioteka online ishte pa pagesë dhe interneti i aksesueshëm në mjediset e UAMD. Nga biseda me studentët, rezultoi që edhe ata e preferonin literaturën online në formatin elektronik, si artikuj, teza të disertacionit të stafit akademik të UAMD, sipas lëndëve dhe orientimit të pedagogëve. Biblioteka e ndodhur në katin e katërt që GVJ vizitoi kishte 20 vende qëndrimi pa kompjutera, ngjitur me të ishin dy laboratorë me kompjutera që mund ti përdornin edhe studentët për aksesimin e Bibliotekës online si Cobiss.al <i>(Evidenca Nr.91 Licensimi i programeve kompjuterike; Evidenca 97. Të dhëna për infrastrukturën).</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka plotëson nevojat e studentëve për literaturë bazë dhe ndihmëse duke ofruar edhe versionin on-line në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët. Aksesimi i Bibliotekës online sigurohet si brenda institucionit, edhe jashtë ambienteve të universitetit. Studentët kanë akses në EBSCO, një nga bibliotekat online që ofron Libra universitarë dhe artikuj shkencorë elektronikë nga Oxford University dhe të tjera universitete të njohura botërore.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve në oraret e funksionimit të UAMD, sipas nevojave të studentëve, sikurse u konfirmua nga biseda me bibliotekaren dhe studentët e këtij programi studimi. Përderisa disa leksione për ciklin e dytë të studimeve Master zhvillohen në fundjavë, që më 2019 Rektori ka miratuar një Memo që edhe Biblioteka të jetë funksionale të shtunë e të dielë. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në faqen online të universitetit. <i>(Evidenca nr. 82. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës për fundjavë, 2019-2020).</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe	Departamenti vazhdon traditën me planifikimin vjetor për blerjen e literaturave bashkëkohore për realizimin e programit të studimit për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës. Nga biseda me bibliotekaren konstatuam se vitet e fundit nuk ka pasur shtim të librave fizikë, pasi vëmendja ka qenë në mundësimin e

<p>fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>bibliotekave online. Çdo student dhe lektor ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave për burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik. Me shfrytëzimin e sistemeve open access, biblioteka e Universitetit ka instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. UAMD është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar, e cila i krijon mundësinë e aksesimit në Platformën e Bibliotekës Elektronike ULIBRARY si edhe në databazet elektronik si:</p> <p>https://op.europa.eu/, https://www.unrisd.org/, www.ebsco.com/, https://www.elgaronline.com/; https://msp.org/publications/journals/, https://onlinelibrary.Wiley.com/, https://librarianresources.taylorandfrancis.com.</p> <p>UAMD, ka një marrëveshje bashkëpunimi për aksesim pa pagesë në platformën universitare “Coursera”, e cila mundëson 4.000 kurse ndërkombëtare online, me mbi 200 universitete të huaja partnere. (Evidenca 51. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD; Evidenca 113. Kostot e programit).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Politike ndonëse referon një literaturë të pasur tek studentët për të realizuar programin e studimit, duhet të shtojë literaturën e nevojshme fizike të përditësuar në bibliotekën e tij në mbështetje të mësimdhënies. Biblioteka ka pasur prurjet e fundit me libra fizike në vitin 2016. Mundësitë me literaturat online janë të pëlqyeshme, si për stafet akademike edhe për studentët e Masterit Shkencor. Aksesit në to është i njëjtë për të gjithë, si në mjediset e brendshme të UAMD, ashtu dhe në ato të jashtme të kampusit të ri universitar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të një sërë dokumentesh, GVJ vlerëson se strukturat akademike dhe ndihmës akademike në UAMD, nga sekretariatë deri tek Zyra e Komunikimit Alumnit dhe Karrierës, sigurojnë administrimin e gjithë informacionit në lidhje me studentët, nga regjistrimi për studentët e rinj, informimi në mënyrë të vazhdueshme për oraret, lëndët, provimet, mundësitë që ata kanë për trajnime, mobilitete apo praktika profesionale gjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre, deri në diplomim. GVJ shqyrtoi nëpër regjistrat standard një bazë të dhënash të plota e të përditësuara mbi studentët të tilla si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e regjistrimit në universitet, datë çregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), datën e diplomimit. <i>(Evidenca_Nr.11 Manual për funksionimin e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca_Nr.68 Të dhëna të plota në MND për regjistrimin, ecurinë, çregjistrimet, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, 2018-2019; Evidenca.86. Udhëzues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidencë 122. Informacion nga - Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca_Nr.90 Përdorimi i Sistemit elektronik).</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në UAMD, Struktura e Burimeve Njerëzore i vuri në dispozicion GVJ bazën e të dhënave që përmbante informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”. <i>(Evidenca Nr.17 Rregullore për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD; Evidenca Nr.65 Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Programin e Studimit MSH MND; Evidenca Nr.69 Përmbledhëse për stafin akademik ndër vite xls).</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë</p>	<p>Gjatë vizitës në UAMD, GVJ bëri kërkesën për aksesin në dokumente dhe informacione për persona të caktuar nga stafi akademik me zgjedhje rastësore dhe sektori i Burimeve Njerëzore u përgjigj pa hezitim; po ashtu sekretaria mësimore na siguroi të</p>



personelin dhe studentët e programit të studimit.	dhëna të dedikuara për disa studentë të Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Të dhënat garantohen si për personelin dhe studentët në mënyrë fizike dhe virtuale nëpërmjet zonës së studentit në websitin e UAMD dhe në sistemin e përdorimit elektronik për stafin akademik, për fakultetet dhe programet e studimit që ofrohen.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma AULA dhe Pitagora që po pilotohen mundësojnë komunikimin interaktiv dhe transmetimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, nga lektori te studenti në konfidencialitet të plotë. Njëherazi, nëpërmjet faqes zyrtare të UAMD, sikurse edhe sekretarisë, Përgjegjësit të Departamentit dhe zv. Dekanit bëhet e mundur konsultimi dhe komunikimi me studentët. (Evidenca Nr.103 Sistemi AULA; Evidenca 90. Sistemi Pitagora; Evidenca 107. Faqja zyrtare e UAMD).			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjatë vizitës në UAMD, konstatoi se Sistemi i menaxhimit garanton informacionet mbi aktivitetet akademike e administrative në kohë reale, të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportime individuale. (Evidenca Nr.87 Strategjia e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit 2020-2025; Evidenca Nr.86. Udhëzues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca Nr.11 Manual për funksionimin e Sekretarisë Mësimore ne Fakultetin e Shkencave Politike Juridike).			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja web www.uamd.edu.al përmban të gjitha informacionet mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë të përditësuara në faqen e internet të UAMD (Evidenca 107. Faqja zyrtare e UAMD www.uamd.edu.al).			
Konkluzione	GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimor, gjykon se UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Moro Bani

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UAMD si institucion që financohet nga buxheti i shtetit, harton rregullisht një raport financiar për kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. Për programin e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor që zgjat dy vjet, Plani hartohet nga Departamenti i Shkencave Politike duke marrë në konsideratë realizimin e objektivave të programit të studimit, kërkesave të stafit dhe studentëve. <i>(Evidenca Nr.113 Kostot e Programit. xlsx; Evidenca 140. Plani financiar.doc).</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit përfshihet në planin financiar të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike dhe ky i fundit në atë të Universitetit. Nga evidencat e shqyrtuara gjatë vizitës në institucion dhe ato në faqen online të ASCAL, GVJ konfirmon se Plani mban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orët mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme, kualifikimeve afatshkurtra dhe afatmesme, brenda dhe jashtë vendit, projektet, aktivitete shkencore e shpenzimet e ndryshme operative, etj. <i>(Evidenca Nr.93. Raporti 5 vjeçar i Veprimtarisë Audituese 2013-2018; Evidenca Nr.113 Kostot e Programit. xlsx; Evidenca 140. Plani financiar.doc).</i> <i>Në faqen e ASCAL mungon Evidencë 150. Projekte kërkimore të financuara nga UAMD referuar në RVB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen</p>	<p>Auditimi financiar si një procedurë e përvitshme në institucionet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

54

Mona Bani

auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	publike kryhet si nga Auditi i brendshëm në UAMD, edhe nga auditi i jashtëm, vërtetohet se janë kryer sipas udhëzimit për auditin e brendshëm në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Këto audite dëshmojnë efektivitetin financiar të institucionit (<i>Evidenca Nr.93. Raporti 5 vjeçar i Veprimtarisë Audituese 2013-2018</i>).			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik edhe nga Departamenti i Shkencave Politike, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. (<i>Evidenca Nr.93. Raporti 5 vjeçar i Veprimtarisë Audituese 2013-2018</i>).			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Të dhënat financiare dëshmojnë se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për zhvillimin e programit të studimit. Planet financiare hartohen/provizohen nga Departamenti i Shkencave Politike, sikurse u konfirmua nga takimi me stafin akademik të tij, i përcillen Dekanatit, Rektoratit dhe ky Senatit Akademik, e pastaj i kalohen për miratim Bordit të Administrimit, në përputhshmëri të plotë me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastet e riskut të reduktimit të numrit të studentëve, dhe për rrjedhojë edhe i të ardhurave financiare të lidhura me studentët në të ardhmen, Departamenti ka synuar diversifikimin e financimeve duke aplikuar dhe fituar disa projekte kërkimore dhe bashkëpunime me universitete evropiane.			
Konkluzione	<i>GVJ duke e vlerësuar nga këndvështrimi i një institucioni që mbështetet nga buxheti i shtetit, vlerëson se UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve, pavarësisht se numri i studentëve në Bachelor në Shkenca Politike ka pasur rënie të ndjeshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga vizita në UAMD dhe bisedat me studentët dhe stafin administrativ e drejtuesit, GVJ vlerëson se politikat dhe procedurat që shoqërojnë procesin nga hyrja në dalje të studentëve, përgjatë gjithë ciklit të studimeve, mbështeten në legjislacionin në fuqi, Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr.436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e ciklit të dytë. Po ashtu, edhe aktet rregullatore të institucionit të tilla si: Statuti i UAMD (Evidenca nr.1); Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike (Evidenca Nr.7); Rregulloren e Master (Evidenca Nr.9) në zbatim të ligjit konfirmojnë procedurat korrekte për kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve të ciklit të dytë për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim. (Evidenca 119.1. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve; Evidenca 119.2 Vendim Senati për kuotat; 119.3 Vendim Senati për tarifën dhe pagesat studentore; Evidenca Nr.50 Praktikë për procesin e transferimeve).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të	Mundësi të barabarta për të gjithë në hyrje dhe në dalje, garantohen nëpërmjet politikave dhe procedurave për studentët e programit të studimit në të gjithë ciklin e studimit. Kriteret dhe procedurat kryhen nëpërmjet një procesi transparent të vlerësimit dhe përzgjedhjes së aplikantëve duke respektuar kuotat e pranimit, përfshirë këtu edhe kuota për kategori të veçanta si për

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

56

Mona Bevi

studimit.	studentë nga trojet, pakicat kombëtare, me status jetimi si dhe personat me aftësi të veçanta.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Programi i transparencës në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës mbështetet në parimin e së drejtës për informim për kriteret e përgjithshme e të veçanta të në çdo program studimi që u bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Referuar dokumenteve si Statuti i UAMD, Rregulloreve, Kodi i Etikës së Universitetit, si dhe vendimeve apo udhëzimeve në lidhje me kuotat, tarifat e studimit, kriteret e pranimeve të studentëve, si dhe nga takimet në UAMD, GVJ gjykon se ato hartohen në bashkëpunim mes Departamentit të Shkencave Politike dhe strukturave të ngritura në zbatim të kuadrit rregullator.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Gjatë vizitës në UAMD, bisedave me studentët dhe shqyrtimit të faqes online të universitetit, GVJ gjykon se aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me kriteret dhe procedurat e programit të studimit në Departamentin e Shkencave Politike, si një ndër Njësitë bazë të tij, bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit dhe mjeteve të komunikimit për studentët dhe të gjithë të interesuarit. gjatë të gjithë ciklit akademik. Ato mbështeten në Statutin e UAMD; Rregulloren të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Rregulloren e Masterit; si dhe në Programin e Transparencës UAMD. (<i>Evidenca nr.1 Statuti i UAMD; Evidenca Nr.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.9 Rregullore e Masterit; Evidencë 50. Praktikë për procesin e transferimeve; Evidenca Nr.74 Programi i Transparencës UAMD</i>).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UAMD mundëson informimin e përvitshëm të studentëve dhe të gjithë personave të interesuar mbi kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit, ku stafi i departamentit të Shkencave Politike i orienton për programin Master. Faqja online e UAMD dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit. GVJ i konfirmoi këto gjatë takimit në institucion me stafin e departamentit dhe studentët. (<i>Evidencë 48. Fletëpalosje 10 arsye për të zgjedhur UAMD; https://www.uamd.edu.al</i>).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

57

<p>akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Republikën e Shqipërisë" si dhe VKM-në Nr. 39, datë 23.01.2019 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, UAMD ka hartuar dhe publikuar kriteret për kategori të veçanta. Konkretisht, studentët që vijnë nga shtresa sociale "rome-egjiptiane" të cilët ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%.Për studentët me aftësi të veçanta në godinat e UAMD-së është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme për të lehtësuar lëvizjen e tyre si ashensore, të cilët e provoi edhe GVJ gjatë vizitës në institucion, si dhe ka miratuar Rregulloren e Brendshme për Trajtimin e Studentëve me aftësi të Kufizuara në UAMD (Evidencë 18. Rregullore për Studentët me Aftësi të Veçanta; Evidencë 119.3. Vendimet për tarifën dhe pagesat studentore cikli 2).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Përpara çdo viti akademik, Institucioni miraton me vendim Senati kriteret dhe procedurën për pranimin e studentëve për programin Bachelor në Shkenca Politike, të cilët mund të vazhdojnë edhe në ciklin Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci me një koeficient 1.2, krahasuar me studentët nga degët e tjera të Bachelorit. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjtat me aplikantët brenda vendit, por kuotat janë të dedikuara për këto kategori, konkretisht me Vendim e Senatit për vitin 2021-2022 kishte një kuotë për studentë të haj. Aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. (Evidenca 119.1. Vendim Senati për Kriteret e Pranimin të Studentëve; Evidenca 119.2 Vendim Senati për kuotat).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UAMD ka politika mbështetëse për studentët e kategorive sociale të veçanta. që përfiton bursë në masën 100% (Bachelori) ose 50% për studentët e ciklit të dytë master shkencor, bazuar në VKM nr. 780, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë. (Evidencë 119.4. Vendimet për tarifën dhe pagesat studentore).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD harton dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve,</p>

	<i>transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Master në "Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci". Institucioni harton politika të ndihmës për shtresa në nevojë deri në 50% reduktim i tarifës dhe për të rritur cilësinë me mbështetje për studentët ekselentë. UAMD i bën këto publike në faqen zyrtare dhe buletine informative.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ nga biseda me studentët konfirmon se UAMD u siguron studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, të cilat specifikohen në dokumentet e brendshme të UAMD. <i>(Evidenca Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.9 Rregullore e Master Shkencor Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; Evidenca Nr.11 Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike).</i> Nga viti 2010 ka pasur në përdorim një sistem të integruar menaxhimi të rekordeve të studentëve të ciklit të parë të studentëve (AULA). <i>(Evidenca Nr.103. Sistemi AULA; Evidenca Nr.107 Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it të UAMD).</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme, të plota ose të pjesshme, janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD sipas sistemit të krediteve. GVJ nga bisedat me studentët konfirmon se ata janë të informuar në lidhje me kriteret që për transferimin e studimeve duhen 30 kreditet minimale. Referuar në Programin e Transparencës UAMD, kriteret janë të kuptueshme e të aksesueshme për studentë dhe të gjithë të interesuarit. <i>(Evidenca. Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave</i>

	<i>Politike Juridike; Evidenca Nr.9 Rregullore e Master Shkencor Marrëdhënie Ndërkombëtare Evidenca Nr.74. Programi i Transparencës UAMD).</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ bazuar në bisedat me stafin akademik, studentët dhe në kuadrin rregullator të UAMD konfirmon se kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive ju bëhen me dije studentëve nga lektorët e lëndëve respektive që në orën e parë mësimore; po ashtu ato janë të shpallura në broshura informative dhe katalogut studentor, si dhe në faqen online të UAMD. <i>(Evidenca Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.9 Rregullore e Master Shkencor Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci).</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UAMD ka miratuar Rregulloren e Provimeve dhe Rregulloren e Tezës së Diplomës në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, Rregulloren e diplomimit dhe strukturën e mikrotezës, si dhe Udhëzues i diplomimit të cilat u bëhen me dije studentëve që me fillimin e studimeve. Krahas tyre, pedagogët që supervizojnë temat e diplomave i asistojnë nga afër studentët, sikurse u konfirmua nga bisedat me stafin akademik në UAMD. <i>(Evidenca Nr.13 Rregullore e Provimeve në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.14 Rregullore e Tezës së Diplomës në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.110 Relacion për aktivitetet studentore).</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ, nga bisedat me stafin dhe studentët e Departamentit të Shkencave Politike, del qartë që në fillim të çdo viti akademik ata ndërmarrin një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura për tërheqjen e kandidatëve potencialë për studentë të masterit. Faqja online e UAMD dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit (https://www.uamd.edu.al).
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UAMD u siguron studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit në fillim të çdo viti akademik. UAMD ka rregulla të detajuara për përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim me rregulloren e provimeve, e strukturës së tezës së diplomës, rregulloren e diplomimit në këtë program të</i>

	<i>studimeve Master. Informimi bëhet në fillim të vitit akademik përmes takimeve të organizuara me studentët, nga stafi i Departamentit dhe titullarët e lëndëve për programet respektive, nga broshurat dhe faqja online e UAMD të cilat sigurojnë informacione të detajuara edhe për tërheqjen e kandidatëve të mundshëm</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ pas bisedës me stafin e Departamentit dhe studentët konfirmon se në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Shkencave Politike informon dhe orienton studentët me planin mësimor, kohëzgjatjen dhe strukturën e programit Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Statuti dhe Rregullorja e UAMD, Katalogu i programeve të Studimit, Guida Studentore, janë dokumente me të cilat studentët informohen në mënyrë të hollësishme për të gjithë komponentët e programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Stafi me përvojë i Departamentit të Shkencave Politike dhe studentët i prezantuan GVJ gjatë vizitës në UAMD, se sa i takon kurrikulës dhe lëndëve të programit të studimit, përmbajtjes së syllabuseve dhe organizimit të veprimtarisë formuese ata janë të familjarizuar që në fillim të studimeve. Njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit i ka bërë transparente të dhënat e tyre edhe në faqen online me shpalljen e Planit Mësimor të Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci të periudhës 2018-2021 dhe në vazhdim. (<i>Evidenca_Nr.107 Të dhëna nga faqja zyrtare e UAMD; Evidenca Nr.24. Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; Evidenca Nr.24.1 Plani Mësimor në MSH MND 2020-2021 dhe syllabuse DSHP</i>).
Kriteri 3. Institucioni	Nga takimi i GVJ me specialisten e zyrës së Këshillimit dhe

Muse *Bevi*

informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Karrierës, vlerësojmë se kjo strukturë përgjegjëse informon dhe këshillon studentët për mundësitë e praktikavë mësimore, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe mbi mundësitë të punësimit. UAMD e ka formalizuar këtë veprimtari në Rregulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. (Evidenca Nr.76 Njoftimet për punësim të studentëve dhe alumni; Evidenca Nr.86 Udhëzues – Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidencë 102. Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës).			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Stafi i UAMD i vuri në dispozicion GVJ informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Po ashtu GVJ vizitoi mjediset për instrumentet logjistike të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor në Masterin Shkencor MND, i cili nuk kërkon ndonjë logjistikë dhe infrastrukturë të sofistikuar. Informacioni mbi to është lehtësisht i aksesueshëm për studentët nëpërmjet Departamentit të Shkencave Politike dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit online nga UAMD, sikurse u konfirmua gjatë bisedës së GVJ me studentët (Evidenca Nr.107 Të dhëna nga faqja zyrtare e UAMD).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ gjatë vizitës në UAMD konfirmoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit mundësohet nga platformat përkatëse që u siguron studentëve informacionin e detajuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm lehtësisht kudo që ata ndodhen. (Evidenca Nr.86 Udhëzues – Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca Nr.107 Të dhëna nga faqja zyrtare e UAMD).			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UAMD vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit, i lehtësuar nga platformat përkatëse, i ofron studentëve informacion të detajuar e të përditësuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm lehtësisht kudo që ata ndodhen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

62



Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UAMD, si institucion publik i arsimit të lartë, respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në Ministrinë e Arsimit të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve. GVJ e konfirmon këtë pas shqyrtimit të evidencave të vena në dispozicion nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike. Kjo zyrë ka përgjegjësinë të mbledh të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar në programin e studimit (<i>Evidenca Nr.11 Manual i Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.68 Të dhëna të plota në MND për rregjistrimin, ecurinë, çrregjistrimet</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Përmes Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike GVJ u njoh me statistika vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë Master MND sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Të dhënat përditësohen me tërheqjet apo largimet para përfundimit të programit, deri tek diplomimet apo ata që nuk i kanë përfunduar ende studimet me sukses atë vit akademik (<i>Evidenca Nr.11 Manual i Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.68 Të dhëna të plota në MND për rregjistrimin, ecurinë, çrregjistrimet; Evidenca Nr.132 Dept. Shkenca Politike, Statistika studentë 2018-2022</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ provoi gjatë vizitës në UAMD se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, të cilat përftohen edhe nga sistemi Pitagora. Edhe në këtë rast shkëmbimi i të dhënave realizohet me anë të komunikimit zyrtar midis drejtuesve të FSHPJ dhe sekretarisë (<i>Evidencë 90. Sistemi PITAGORA (RASH)</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi aktet e nxjerra nga UAMD si Rregullore, Manuale, Udhëzime, si dhe referuar sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave statistikore të studentëve, vlerëson se</p>

<p>përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike i ka të pasqyruara këto në raportet periodike të tij për çdo vit akademik mbi veprimtarinë e tyre. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare nga titullari i lëndës, sekretaria mësimore i pasqyron notat si në rregjistra edhe në bazën elektronike të të dhënave. (Evidenca 6. Rregulloren e UAMD; Evidenca 7. Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca 11. Manual i Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca 89. Raporti vjetor 2021-2022; Evidenca 146. Analiza vjetore e Dep. Shkencave Politike).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ nga biseda me Departamentin e Shkencave Politike vlerëson se ata e kishin në vëmendje reduktimin e numrit të studentëve në Bachelor që ka ndikime edhe në këtë degë studimi Master MND, si në bisedat mes tyre edhe në diskutimet në mbledhjet e Departamentit e raportet vjetore. Duke gjykuar se perspektiva e punësimit të studentëve përbën një faktor kyç në këtë drejtim, Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë e përmirësimit të tyre. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës angazhohet për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë. (Evidenca Nr.30 RVB e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike Viti Akademik 2018-2019; Evidenca Nr.29 Pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orientimin e tyre në tregun e punës; Evidenca 146. Analiza vjetore e Dep. Shkencave Politike; Evidenca Nr. 131 Databazë punësimesh Alumni).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD, si institucion publik i arsimit të lartë, respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në Ministrinë e Arsimit të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit dhe studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre pas diplomimit. Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Nga biseda e GVJ me studentët del qartë se ata janë të familjarizuar dhe të angazhuar me çfarë aktivitetesh zhvillohen në Departamentin e Shkencave Politike. Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen e Departamentit realizohet kur ata ftohen në mbledhje ku ka për tu marrë ndonjë vendim që i ndikon ata. Në nivel institucioni, Statuti i UAMD, Rregullorja e UAMD, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, si dhe Rregullorja e Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci specifikojnë procedurat e përfshirjes së studentëve në vendimarrje. <i>(Evidenca Nr.1 Statuti i UAMD; Evidenca Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.9 Rregullore e Master Shkencor Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci).</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ krahas shqyrtimit të dokumentacionit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, si dhe Fakultetit të Shkencave Politike Juridike dhe Departamentit të Shkencave Politike, si Statutit dhe Rregulloreve përkatëse që sanksiononin pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, nga bisedat me stafin akademik dhe studentët konfirmoi se në fund të çdo semestri ata vlerësonin procesin mësimor të programit Master MND. Rëndësia e angazhimit real të studentëve në vlerësimin e procesit akademik vlerësohej pozitivisht nga stafi akademik dhe drejtuesit që reflektonin rezultatet e anketimit të tyre. Po ashtu, pedagogët i përfshinin në projektet e tyre kërkimore, duke u dhënë mundësi të përgatiteshin për punimet e diplomave. <i>(Evidencë 20. Studim për perceptimin e studentëve mbi tregun e punës në profilin marrëdhënie ndërkombëtare).</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e	GVJ gjykon se fakti i një numri të limituar studentësh, ka qenë një nxitje më shumë për Departamentin e Shkencave Politike për

<p>studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>t'i përfshirë ata në diskutime ,qoftë në mbledhje departamenti, apo me pyetësorë për përmirësimin e programit të studimit që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve, ndryshimet për programet e lëndëve, etj. (Evidenca Nr.83 Analiza e pyetësorëve (student, staf akademik, staf administrative; Evidenca Nr.39 Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët; Evidenca Nr.41 Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar).</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Krahas dokumentacionit të UAMD që përcakton mundësitë e studentit të shprehë opinionet përmes kanaleve formale të institucionit, si edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit të notës nga pedagogu, GVJ në bisedën me studentët dëgjoi shembuj që ata sollën për rishikimin e notës. Studentët u shprehën për fleksibilitetin e stafit akademik lidhur me procesin e vlerësimit të dijeve të tyre. Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve është në përputhje me aktet rregullatore dhe programin e lëndës që ju bëhet i njohur studentëve nga pedagogu që në orën e parë të saj.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në argumentet e evidentuara në pjesën përshkrimore. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit dhe pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes si nga UAMD dhe më konkretisht nga Departamenti i Shkencave Politike. Ata ftohen në mbledhjet e Departamentit, kryejnë pyetësorë për procesin e vlerësimit të programit të studimit, përfshirë edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentë .</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Moro *Bevi*

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD ka një dokumentacion që detajon kërkesat ligjore për përcaktimin e procedurave e strukturave të posaçme për informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve. Në sferën akademike, Departamenti dhe stafet akademike ndihmojnë për të orientuar e bashkëpunuar ngushtë me studentët. Sekretaritetë sigurojnë shkëmbimin e informacionit me studentët. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës si njësi përgjegjëse për informimin e studentëve, mbulon një sërë problematikash të tyre, nga orientimi, trajnimi deri tek këshillimi për punësim. (<i>Evidenca Nr.86 Udhëzues – Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me Departamentin dhe NJSBC konkludohet se UAMD ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin dhe tërheqjen e mendimeve dhe ideve të studentëve lidhur me çështje të procesit mësimor e programet e studimit Master MND. Departamenti orienton politikat e tutorialit për mbarëvajtjen e procesit mësimor, kurse Zyra e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës ofron shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të karrierës së studentëve, kurse Këshilli Studentor, i cili mundëson përcjelljen e informacioneve të studentëve në strukturat vendimarrëse të UAMD dhe anasjelltas (<i>Evidenca Nr.70. Rregullore e NJSBC të UAMD; Evidenca Nr.6. Rregulloren e UAMD; Evidenca Nr.7 Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.1 Statuti i UAMD</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës orienton studentët gjatë gjithë ciklit të studimit për mundësitë e praktikave mësimore dhe mundësitë e punësimit përmes kontakteve individuale ose trajnimeve në grup. Zyra vepron edhe duke aktivizuar rrjetet alumni të të diplomuarve për tu sjellë studentëve modele pozitive. Nëpërmjet ofrimit të mundësive për praktikat profesionale duke përdorur marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ana e institucionit, studentëve ju jepet edhe një mundësi punësimi bazuar në aftësitë që ata demonstrojnë (<i>Evidenca 72. Shoqata Alumni UAMD; Evidenca 75. Marrëveshje bashkëpunimi AADF; Evidenca 76. Njoftime për punësim të studentëve; Evidenca Nr.86 Udhëzues – Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca nr.94. Aktivitetet vullnetare të studentëve të UAMD</i>).</p>



<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me Zyrën e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës, konfirmojmë se specialistja e saj mban kontakte të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit, duke aktivizuar rrjetin alumni. Rrjeti Alumni krijon mundësi shpërndarje informacioni për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët, organizon aktivitete për studentët si trajnime, seminare, etj. (Evidenca Nr.41 Formular për gjurmimin e Alumnit; Evidenca 72. Shoqata Alumni UAMD; Evidenca 75. Marrëveshje bashkëpunimi AADF; Evidenca 76. Njoftime për punësim të studentëve; Evidenca Nr.86 Udhëzues – Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD ka një dokumentacion të detajuar që përcakton procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave të studentëve. Departamenti i Shkencave Politike koordinon veprimtarinë e tij me të gjitha strukturat e UAMD të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Faqja online e UAMD gjithashtu lehtëson marrjen e çdo informacioni nga studentët..</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të</p>	<p>GVJ vlerëson që UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, ka krijuar strukturat përgjegjëse si NJSBC dhe aktet rregullative mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive të mësimdhënies. Formatet e syllabuseve mundësojnë që stafet akademike të</p>

<p>mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>përcaktojnë një larmi metodash mësimdhënie, në varësi të subjekteve që mbulojnë. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë mbështetet në manualin për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike. <i>(Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC të UAMD; Evidenca 27. Syllabuset në Master i Shkencave MND)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBC i vuri në dispozicion GVJ gjatë takimit në UAMD formularë të aplikuar në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatori i programit vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik si përmes formularëve të vetëvlerësimit, të vlerësimit nga studentët për çdo lëndë në fund të semestrit, sikurse edhe mbi bazën e treguesve të aktivitetit të tyre shkencor. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike organizon seminare edhe në kuadrin e projekteve ku stafet akademike trajnohen për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe njohjen e metodave inovative. <i>(Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC në UAMD; Evidenca Nr.39 Formular vlerësimi nga studentet; Evidenca Nr.38 Rezultatet e anketimit të studentëve; Evidenca Nr.40 Formular i vetëvlerësimit të Performancës së Personelit akademik; Evidenca Nr.152 Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike mundëson përfshirjen e studentëve përmes formularëve e pyetësorëve, ku edhe vetë pedagogët në fund të lëndës u kërkojnë një vlerësim studentëve të Masterit për procesin e mësimdhënies. <i>(Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC në UAMD; Evidenca Nr.39 Formular vlerësimi nga studentet; Evidenca Nr.38 Rezultatet e anketimit të studentëve; Evidenca Nr.152 Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit gjatë bisedës në institucion konfirmoi se ai i komunikon në mbledhje rezultatet e përgjithshme dhe pastaj çdo pedagogu në veçanti ato specifike. Mbi bazën e analizës së rezultateve të anketimit, departamenti nxjerr problematikat dhe reagon për përmirësimin e tyre, p.sh. u përmend përshtatja e orarit për studentët e Masterit në fundjavë, apo lëndët me zgjedhje. Rezultatet përfshihen në raportin vjetor</p>



	<i>(Evidenca 67. Raport i drejtorisë së sigurimit të cilësisë (tek Raporti vjetor UAMD 2020-2021).</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Promovimi i përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor rezulton nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, të cilët përfshihen në projektet e pedagogëve të cilët kanë avancuar në karrierën e tyre përmes gradave Doktor, Prof.Asoc. dhe Profesor. <i>(Evidenca 10. Rregullore e NJSBC UAMD).</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht pasi UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, ka krijuar strukturat përgjegjëse si NJSBC dhe aktet rregullative mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UAMD si institucion publik ka respektuar kuadrin ligjor për krijimin e strukturave për sigurimin e cilësisë në nivel institucional si NJSBC dhe ka shpallur politika e procedura për vlerësimin periodik të veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore për sigurimin e cilësisë. NJSBC është ngritur edhe në nivel fakulteti për FSHPJ ku aplikohet program i studimit Master Shkencor në MND dhe në përputhje me Rregulloren e funksionimit të saj NJSBC aplikon procedura për përfshirjen e drejtuesve përmes kontrolleve për sigurimin e cilësisë, stafeve akademike përmes vetëvlerësimit dhe studentëve. <i>(Evidenca 10. Rregullore e NJSBC UAMD).</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike ka rishikuar programin e studimit të ciklit të

Mari Berra

<p>Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>dytë Master MND në vitin 2019 për ta bërë më të përshtatshëm për kërkesat e studentëve dhe mundësuar punësimin e tyre. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve me studentët dhe vlerësimet e stafit akademik, si dhe në bashkëpunim me aktorë të komunitetit, si institucionet publike/ OSHC ku studentët zhvillojnë praktikat, Departamenti ka qenë i nxitur për përmirësimet e nevojshme të programit të studimit. Po ashtu, përmes bashkëpunimeve me aktorë të jashtëm si universitetet me të cilat kanë projekte të përbashkëta, janë përmirësuar kurrikulat dhe syllabuset e lëndëve, sikurse doli nga biseda me drejtuesit dhe stafin akademik. <i>(Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.37 Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAMD përdor instrumente të ndryshme për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL dhe UAMD e ka kaluar me sukses akreditimin e jashtëm institucional, kurse programi i studimit po kalon fazën e rivlerësimit periodik. Masteri i Shkencave “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”, është një program i ciklit të dytë të studimeve i riorganizuar në vitin 2019 sipas urdhrit të MASR nr 515, dt. 24.10.2019, mbi programin ekzistues Masteri i Shkencave “Gjeopolitika dhe Sistemet e Sigurisë”, i hapur më 2013. Bazuar në evidencat e dosjes së RVB, UAMD ka dhënë tregues të matshëm dhe procedurat shprehen qartësisht në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, sikurse specifikohet edhe në RVB. Edhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike ka të specifikuar metodologjinë në manualin për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë. <i>(Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.22 Urdhër MASR riorganizimi i programit të studimit; Evidenca Nr.109 Vendimi i Bordit të Akreditimit për UAMD; Evidenca Nr.165 Tabela me të dhënat e vlerësimit nga studentët FSHPJ TOTAL STAF).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet</p>	<p>Nga biseda me stafin dhe përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Politike, si edhe me zv. Dekanan e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, GVJ gjykon se institucioni përdor tregues të ndryshëm të qartë dhe të matshëm si për mësimdhënie edhe kërkim shkencor për vlerësimin e cilësisë. Ato pasqyrohen në raportet e NJSBC, në analizat vjetore të departamentit, në</p>



<p>rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>evidencat statistikore dhe në kontrollet nga drejtuesit e Fakultetit e Departamentit për procesin mësimor. Analizat dhe diskutimet në mbledhje të Departamentit dhe rezultatet e anketimeve të studentëve tregojnë matjet e performancës së pedagogëve sipas disa kriterëve të standartizuara më parë në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Mbi bazën e tyre, UAMD mundëson dhe nxit stafet akademike dhe studentët të afirmohen më tej në pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe Erasmus+. (Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.38 Rezultatet e anketimit të studentëve; Evidenca Nr.39 Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët; Evidenca Nr.41 Model Pyetësori për Studentët e Diplomuar; Evidenca Nr.36 Raporti Vjetor FSHPJ, 2020-2021; Evidenca Nr.105 Monitorimi i procesit mësimor (Rregullore e FSHPJ)).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në shqyrtimin e politikave, strukturave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Periodikisht janë kryer vlerësime të brendshme dhe të jashtme, si për akreditimin institucional edhe atë të programit të studimit Master Shkencor MND, i cili mori këtë emërtim në vitin 2019, pas rishikimit të Masterit të mëparshëm hapur më 2013. Ky është një hap drejt rritjes së cilësisë, përgjigjes ndaj nevojave të studentëve dhe kërkesave të tregut njëkohësisht. Ndërsa vlerësimet e jashtme bëhen në bashkëpunim me ASCAL, vlerësimet e brendshme kryhen përmes një procesi të bashkëpunimit mes strukturave të brendshme si NJSBC, Departamentit të Shkencave Politike, studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm me të cilët Departamenti ka marrëveshje për praktikantët e studentëve. Metodatat janë të ndryshme, që nga pyetësorët, formularët e vetëvlerësimit të stafit akademik, të studentëve, diskutimet në Departament deri tek monitorimet nga drejtuesit e UAMD. Reflektimet pasqyrohen në raporte të cilat janë transparente për të gjithë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi VI.3

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423
 E-mail: info@ascal.al
 Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ pas bisedës me stafin dhe përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Politike, NJSBC dhe drejtuesin e Njesisë së Kurrikulave në UAMD konfirmon se ky program studimi Masterit Shkencor MND ka kaluar në procese shqyrtimi që me vendosjen e tij në vitin 2019. Rishikimi i lëndëve, i syllabuseve dhe sigurimi i stafëve akademike të përshtatshme, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për realizimin e tij kanë kaluar nga departamenti në organet vendimmarrëse. Këto procese janë të dokumentuara në procesverbalet e mbledhjeve dhe në raportet periodike vjetore të Departamentit të Shkencave Politike, të FSHPJ, të NJSBC ku pasqyrohen arritjet, problematikat dhe masat për kapërcimin e tyre për të siguruar përmirësimin e programit të studimit. Pjesë e këtij procesi janë edhe vlerësimet e studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve dhe të efikasitetit të programit të studimit të dokumentuara në raportet përkatëse si dhe raportet e vetëvlerësimit të stafit akademik. UAMD ofron një infrastrukturë të përmirësuar mësimdhënie në kampusin e ri që ka rritur cilësinë e mësimdhënies. (Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.109 Vendimi i Bordit të Akreditimit për UAMD; Evidenca Nr.38 Rezultatet e anketimit të studentëve; Evidenca Nr.39 Formulari i vlerësimit për pedagogët nga studentët; Evidenca Nr.158 Raporti vjetor UAMD, 2019-2020; Evidenca Nr.36 Raporti Vjetor FSHPJ, 2020-2021; Evidenca Nr.30 Raporti i vlerësimit të brendshëm FSHPJ, 2019; Evidenca Nr.37 Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.105 Monitorimi i procesit mesimor (Rregullore e FSHPJ); Evidenca Nr.155 Strategjia e Komunikimit – UAMD).</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit, GVJ gjykon se ato përmbajnë analiza të të dhënave statistikore, të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar, që në tre vitet e para të aplikimit të këtij programi studimi kanë qenë në përputhje me pritshmëritë, p.sh. viti akademik 2019-2020 18 studentë të rregjistruar, në vitin akademik 2020-2021 numri zbrit në 15 dhe</p>

<p>masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>një vit më vonë, 2021-2022 numri i të regjistruarve dyfishohet në 35. Vlerësohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilit pas diplomimit. Po ashtu pasqyrohen rezultate e avancimit të stafit akademik, të pjesëmarrjes së tyre në veprimtari kërkimore shkencore, publikimeve dhe projekteve të Departamentit të Shkencave Politike, apo Fakultetit të Shkencave Politike Juridike Vlerësimi i mbarëvajtjes së programit bazohet në sa ai është tërheqës për studentët dhe përmbush pritshmëritë e tyre edhe për punësim, parametra sasior dhe cilësor të cilët vijnë kryesisht nga statistikat e regjistrimeve, diplomimeve dhe rezultatet e anketimeve dhe të vlerësimit/vetëvlerësimit të stafit akademik. (Evidenca Nr.166 Raport Vjetor, FSHPJ 2019-2020; Evidenca Nr.36 Raporti Vjetor FSHPJ, 2020-2021; Evidenca Nr.98 Raport Vjetor, FSHPJ 2021-2022; Evidenca Nr.19 Analizë Vjetore në Departament për Programin e Studimit Master Shkencor Marrëdhënie Nderkombetare dhe Diplomaci; Evidenca Nr.146 Analiza e Departamentit të Shkencave Politike; Evidenca 152 Raporti i Rezultateve të Anketimit të Studentëve, të Stafit Akademik dhe Administratës),</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo</p>	<p>Në diskutimin e GVJ me stafin akademik u konstatua se në matjen e cilësisë së mësimdhënies për këtë program studimi përdoren metoda dhe instrumenta specifike, që nga format e vlerësimit të larmishme të përcaktuara nga pedagogët në syllabuset e lëndëve, të cilat janë teste me shkrim, prezantime me gojë në auditor, apo kërkohet punë e pavarur me projektet e kursit, si dhe me përfshirje në projektet kërkimore të pedagogut. Përtej këtij niveli të vlerësimit në auditor, në mënyrë që të sigurohet të mësuarit jo vetëm të koncepteve teorike, por edhe të lidhjes me analiza të situatave konkrete, gjatë kryerjes së praktikës, monitorimit të saj dhe finalizimit me raportet e studentëve.</p> <p>Nga ana tjetër, biseda e GVJ me drejtuesin e Kurrikulave, vlerësojmë se UAMD monitoron realizimin e programit të studimit sipas standardeve shtetërore të cilësisë, duke lejuar ndryshimet e tij deri në masën 20% në vit. (Evidenca Nr.36 Raporti Vjetor FSHPJ, 2020-2021; Evidenca Nr.30 Raporti i vlerësimit të brendshëm FSHPJ, 2019; Evidenca Nr.105</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

74



<p>kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Monitorimi i procesit mesimor (Rregullore e FSHPJ; Evidenca Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.37 Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike).</i></p>			
<p>Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Nga shqyrtimi i raporteve të NJSBC dhe bisedat me stafin dhe studentët, GVJ vlerëson instrumentat e përdorura për vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit. Këto përfshijnë metodat e tërthorta të NJSBC si sondazhe të opinionëve të studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar, si dhe të institucioneve ku ata bëjnë praktikën, si dhe metodat e drejtpërdrejta me intervista të stafit akademik e ndihmës akademik. Këto metoda janë pasqyruar në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, po ashtu në Rregulloren e UAMD. <i>(Evidenca Nr.36 Raporti Vjetor FSHPJ, 2020-2021; Evidenca Nr.30 Raporti i vlerësimit të brendshëm FSHPJ, 2019; Evidenca Nr.105 Monitorimi i procesit mesimor (Rregullore e FSHPJ; Evidenca Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.37 Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UAMD, si institucion publik i monitoruar nga ASCAL për akreditimin institucional dhe atë të programeve të studimit, ka vendosur dhe zbaton systemin e brendshëm për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë përmes njësisive të posaçme si NJSBC. Kjo njësi zbaton rregulloren e saj për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë që pasqyrohet në raportet periodike. Po ashtu, një strukturë tjetër si Drejtoria e Kurrikulave monitoron programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet, duke siguruar që syllabuset të kenë pasqyruar saktë këto komponentë dhe pedagogët t'i zbatojnë ato në mënyre rigoroze. Studentët përmes pyetësorëve sjellin vlerësimet e tyre për arritjen e synimeve të programit të studimit, si dhe përshtypjet e bashkëpunëtorëve të institucioneve ku ata bëjnë praktikën.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

75

Marsa Bera

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin si Statutin dhe Rregulloren e UAMD, si dhe Rregulloren e NJSBC, vlerëson se institucioni i ka të parashikuara politikat dhe procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë. Po ashtu, gjatë vizitës në institucion konfirmuam se këto politika zbatohen përmes një procesi të përfshirjes së strukturave të brendshme si NJSBC, Drjetoria e Kurrikulave, Departamenti me stafin e tij dhe studentët. Programi i studimit është riorganizuar në vitin 2019 për përmirësimin e kurrikulës dhe tërheqjes së studentëve. Ky ndryshim erdhi si produkt i konsultimit të asamblesë së departamentit, ndryshimeve periodike të programeve lëndore, të cilat miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të vitit akademik, dhe kërkesave të studentëve dhe përshtatshmëria e tyre me tregun e punës. (Evidenca Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.167 Raport i Vlerësimit të Brendshëm të Programave dhe Aktivitetit Akademik të DSHP; Evidenca Nr.6 Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2019-2021).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin si Statutin dhe Rregulloren e UAMD vlerëson se përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara dhe të specifikuar më tej në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike. UAMD përmes raporteve të vlerësimit të vëna në dispozicion dhe bisedave të GVJ me stafet akademike dhe studentët konfirmon se institucioni garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave përmes strukturave përgjegjëse si NJSBC, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politike dhe duke kërkuar vlerësimet periodike të studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. (Evidenca Nr.6</p>

Mora *Bevi*

	<i>Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.167 Raport i Vlerësimit të Brendshëm të Programeve dhe Aktivitetit Akademik të DSHP).</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Nga vizita në institucion, GVJ konfirmon se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në MND përfshihen Departamenti i Shkencave Politike, pedagogët, struktura e Sigurimit të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, stafi ndihmës akademik dhe administrativ si sekretarët dhe studentët. Këto rregulla procedurale janë të sanksionuara edhe në Statutin dhe Rregulloren e UAMD dhe të provuara edhe në RVB për këtë program studimi ku ekipi përbëhet nga pedagogë të Departamentit, të stafit administrative dhe studentëve. <i>(Evidenca Nr.6 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.167 Raport i Vlerësimit të Brendshëm të Programeve dhe Aktivitetit Akademik të DSHP).</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<i>Nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit GVJ konfirmon se ato respektojnë etikën dhe integritetin akademik të personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në Departamentin e Shkencave Politike. Sikurse u diskutua me përgjegjësen e Departamentit dhe të NJSBC, për çdo vërejtje konkrete në adresë të stafit akademik që ka dalë nga procesi i vlerësimit, ata kontaktohen veçmas duke shmangur çdo keqkuptim për këtë proces. Po ashtu, edhe vlerësimet e studentëve janë anonime, për të siguruar çdo qëndrim negativ ndaj kritikave të tyre. Specifikisht këto standard referohen në Rregulloren e NJSBC në UAMD. <i>(Evidenca Nr.10 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca Nr.36 Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike).</i></i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e	Në procesin e vlerësimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UAMD ka përfshirë edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi, bazuar në Rregulloret ku përcaktohen kritere të tilla të funksionimit të këtij sistemi. Bashkëpunëtorët apo ekspertët e jashtëm, të cilët në rastin e Departamentit të Shkencave Politike janë edhe të diplomuarit e tij, kanë dhënë vlerësimet e tyre si për praktikën e studentëve, ashtu edhe për tematikën të lidhura me programin e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

77

mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	studimit gjatë aktiviteteve ku ata janë ftuar në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike dhe në Universitet. Kjo i ka shërbyer përmirësimin të cilësisë së programit të studimit. (Evidenca 45. Marrëveshjet e bashkëpunimit FSHPJ; Evidenca 79. Forume, Seminare dhe workshope akademike të organizuara në UAMD).			
Konkluzione	GVJ konfirmon se UAMD përfshin në proceset e SBC-së të programit të studimit njësitë akademike si NJSBC, Drejtorinë e Kurrikulave, Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit për pyetësorët me studentët, Drejtuesin e Departamentit të Shkencave Politike, personelin akademik dhe studentët e bashkëpunëtorët e jashtëm në marrëveshje institucionale. Palët e interesuara si stafet akademike, ndihmës akademike, studentët apo të tjerë bashkëpunëtorë informohen në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre përmes takimeve, raporteve, aktiviteteve të organizuara në UAMD, ndonëse ato nuk janë bërë publike në faqen online të UAMD.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë bërë transparente në raportet me të cilat janë njohur stafet akademike, qoftë nëpërmjet mbledhje apo njoftime me e-maile apo nëpërmjet faqes online të UAMD. Po ashtu, studentët informohen periudikisht për veprimtaritë në lidhje me programin e studimit dhe përmirësimin e cilësisë. Transparenca si parim saksionohet si në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD. (Evidenca Nr.100 Procesverbale mbledhje në Departamentin e Shkencave Politike; Evidenca Nr.36 Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.146 Analiza vjetore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidenca Nr.107 Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it e UAMD).			

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të programit të studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik dhe studentëve, ndonëse nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të UAMD. <i>(Evidenca Nr.74 Programi i Transparencës UAMD; Evidenca Nr.36 Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca Nr.38 Rezultatet e anketimit të studentëve; Evidenca Nr.107 Të dhëna nga faqja zyrtare e web-it e UAMD).</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike bazuar në rezultatet e vlerësimit, angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime në ndryshime të pjeshme të kurrikulës të programit të studimit, përtëritje të stafit akademik, rritje të bashkëpunimit me institucione të tjera, ndryshime rrënjësore për riorganizimin e këtij programi studimi në 2019.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike, edhe nga analizat, Departamenti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike vlerësojnë ecurinë e strategjive të ndjekura në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë dhe marrin masat e nevojshme për përmirësime të mëtejshme. Konkretisht projektet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda e jashtë vendit i shërbejnë këtij qëllimi sikurse edhe prioritetit të ndërkombëtarizimit të shpallur nga UAMD.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura me personelin akademik dhe studentët. Ky është hapi i parë për rritjen e ndërgjegjësimin të tyre për t'u mobilizuar në rritjen e cilësisë së programit të studimit <i>(Evidenca Nr.74 Programi i Transparencës UAMD; Evidenca Nr.146 Analiza vjetore e Departamentit të Shkencave Politike; Evidenca Nr.36 Raporte të Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit përfshijnë të gjithë aktorët e interesuar, strukturat, stafet akademike dhe studentët, diskutohen në takime dhe evente të organizuara në UAMD, me synim krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë. Megjithatë, raportet e vlerësimit janë ende të pa publikuara në faqen online të UAMD, 'veçanërisht tek</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

79



	<i>rubrika Transparenca.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Pikat e forta dhe afirmime

1. Departamenti i Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike të UAMD ofron programin e studimit Master Shkencor në MND në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. Megjithatë Shkenca Politike aktualisht nuk ndodhen në të njëjtin klasifikim sipas ISCED me ato Juridike, të parat i takojnë Kategorisë 3. Shkenca Sociale, të dytat Kategorisë 4. Administrim Biznesi dhe Jurisprudencë.
2. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Së fundmi, avancimi në vitin akademik 2023-2024 me diplomë të dyfishtë Bachelori në Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomaci me Universitetin e Genovës përforcojnë ekspertizën thelbësore të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci.
3. Programi i studimit mundëson dhe nxit studentët dhe pedagogët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Megjithatë, mungon një orientim i qartë për stafin akademik të programit të studimit në përfshirjen e tyre në kërkimin akademik dhe publikime.
4. Ekziston një kornizë për përfshirjen e studentëve në nivele të ndryshme të punës së institucionit, duke përfshirë edhe këtë program studimi në sigurimin e cilësisë së tij.
5. Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe cilësore pasi ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit të studimit.
6. Stafi akademik është i familjarizuar me përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies. Përveç formave tradicionale të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet leksioneve, transmetimi i dijeve e njohurive bëhet edhe nëpërmjet seminareve, detyrave të kursit, orëve të hapura, praktikave profesionale, dhe supervizimi i punimit të diplomës. Megjithatë, mjetet si për mësimdhënien, ashtu edhe për vlerësimin e mësimdhënies mund të zgjerohen edhe me metoda të tjera.



7. Institucioni ka hartuar procedurë të qartë të detyrimeve të studentit me rregullore e struktura të detajuara për punimin e diplomës, si faza përmbyllëse e studentit në programin e studimit. "Mikro-Teza" është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij. Megjithatë, emërtimi i tezës përmbyllëse si Mikrotezë është problematik duke pasur parasysh rëndësinë që ka një tezë në studimet Master Shkencor.
8. Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit.
9. UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit kanë nënshkruar një sërë marrëveshjes me institucione publike, biznese dhe OSHC.
10. Departamenti i Shkencave Politike referon një literaturë të pasur tek studentët për të realizuar programin e studimit me platformat online, të pëlqyeshme, si për stafet akademike edhe për studentët e Masterit Shkencor. Aksesit në to është i njëjtë për të gjithë, si në mjediset e brendshme të UAMD, ashtu dhe në ato të jashtme të kampusit të ri universitar.
11. Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.
12. Si një institucion që mbështetet nga buxheti i shtetit, vlerëson se UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.
13. UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.
14. Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të mësimdhënies sipas standardeve shtetërore.

Pika të dobta

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

82



1. Mungon një studim specifik i fundit i tregut të punës që lidhet me programin e studimit MND.
2. Biblioteka nuk është furnizuar me tekste të reja në mbështetje të mësimdhënies që nga viti 2016.
3. Mungesa e transportit publik të shpeshtë gjatë orarit të studimit pasi zona ku ndodhet kampusi i ri i universitetit është pa një popullsi rezidenciale, por e pështatshme si kampus studentët.
4. Pavarësisht kushteve të kënaqshme që ofron godina e UAMD, dhe sipërfaqeve të lira në mjedisin përreth, në UAMD mungojnë mjediset sportive dhe argëtuese për studentët.
5. Leksionet e përkthyer nga pedagogët zëvendësojnë literaturën e detyrueshme apo dhe atë plotësuese, por në disa raste ato nuk disponohen në Bibliotekë që të jenë njëloj të aksesueshme për të gjithë studentët.
6. Mungesa e programeve të ciklit të tretë do të rriste interesin për studentët dhe stafet akademike me titullin profesor.
7. Mungesa mbështetëse e pajisjeve si videoprojektore nëpër auditore, për të gjithë lektorët, gjatë procesit mësimor, të cilët janë të domosdoshëm në disa kurse për efektivitetin e mësimdhënies.

Rekomandime

1. Fakulteti të riorganizohet që Shkencat Politike të jenë bashkë me Shkencat Sociale, pasi sipas klasifikimit ndërkombëtar ISCED, Shkencat Politike nuk ndodhen në të njëjtin klasifikim me ato Juridike, të parat i takojnë kategorisë 3. Shkenca Sociale, të dytat Kategorisë 4. Administrim Biznesi dhe Jurisprudencë.
2. Me avancimin nga Departamenti i Shkencave Politike në vitin akademik 2023-2024 me diplomë të dyfishtë Bachelori në Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomaci me Universitetin e Genovës, ka nevojë të rishikohet edhe kurrikula e këtij program studimi që të përforcohet ekspertiza thelbësore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacies sipas përvojave evropiane.
3. Programi i studimit Master Shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci” ndonëse është informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë, dhe sipas komponentëve të nevojshëm, ai është përballur me sfida për t’u përshtatur me nevojat e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve.



4. Pas gati 5 viteve të zbatimit të këtij program studimi, del nevoja e një studimi specifik të tregut të punës që lidhet me programin e studimit Master Shkencor në MND.
5. Programi i studimit mundëson dhe nxit studentët dhe pedagogët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Megjithatë ka nevojë për një orientim të qartë institucional për stafin akademik të programit të studimit në përfshirjen e tyre në kërkimin akademik dhe publikime.
6. Metodatat si për mësimdhënien, ashtu edhe për vlerësimin e mësimdhënies mund të zgjerohen edhe me metoda të tjera bashkëkohore.
7. Procedurat me një afat prej 10 ditësh për rekrutimin e stafit joefektiv të rritet dhe të reduktohen dokumentet burokratike për ta.
8. Departamenti i Shkencave Politike duhet të shtojë literaturën e nevojshme fizike të përditësuar në bibliotekën e tij në mbështetje të mësimdhënies.
9. RVB të ketë referenca të sakta të evidencave, pasi përgjatë tij ka pasaktësi në numrin e evidencave të cilat nuk korrespondojnë me ato që janë hedhur në faqen e ASCAL. Me konkretisht, në faqen 56 referohen dy evidenca me nr. 208 dhe Evidenca_Nr.107_Të dhëna nga faqa zyrtare e Web-it të UAMD.
10. Një sugjerim nga bisedat në UAMD ishte që afati prej 10 ditësh për rekrutimin e stafit joefektiv të rritet dhe të reduktohen dokumentet burokratike për ta si librezat shëndetsore, etj.
11. Hapja e programeve të ciklit të tretë do të rriste interesin për studentët dhe stafet akademike me titullin profesor.

Conclusions of the Evaluation of the Master of Science program in "International Relations and Diplomacy" offered by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" Durrës University - UAMD

Strengths and Affirmations

1. The Department of Political Sciences at the Faculty of Political and Legal Sciences of UAMD offers the Master of Science study program in MND in accordance with its mission and purpose, which aims to preserve national interests and values, as well as in accordance with the development strategy, the statute and its other regulatory acts. However, Political Sciences are currently not in the same classification according to ISCED as Law, the former belong to Category 3. Social Sciences, the latter to Category 4. Business Administration and Jurisprudence.



2. The study program is in accordance with the academic field of the main and basic unit responsible for the study program in the institution. Finally, the advancement in the academic year 2023-2024 with the double degree Bachelor in International Sciences and Diplomacy with the University of Genoa reinforce the essential expertise of the field of international relations and diplomacy.
3. The study program enables and encourages students and lecturers to engage in studies, projects and research activities. However, there is a lack of clear guidance for the academic staff of the study program in their involvement in academic research and publications.
4. There is a framework for the involvement of students at different levels of the institution's work, including this study program in its quality assurance.
5. The academic personnel covering the study program meet the quantitative and qualitative standards as they have the appropriate and special academic qualification in accordance with the field of the study program.
6. The academic staff is familiar with the use of different teaching and learning methods. In addition to the traditional forms of teaching and learning through lectures, transmission of knowledge is also done through seminars, course assignments, open classes, professional practices, and thesis supervision. However, the tools for both teaching and teaching assessment can be extended with other methods.
7. The institution has drawn up a clear procedure of the student's obligations with detailed regulations and structures for the thesis, as the final stage of the student's study program. "Micro-Thesis" is an individual study project of the student in the fields of his specialization. However, naming the final thesis as a Microthesis is problematic given the importance of a thesis in Master of Science studies.
8. The institution of higher education makes available learning environments and suitable infrastructure for the realization of the teaching process of the study program.
9. UAMD and the Department of Political Sciences for the practical training of students according to the nature and field of the study program have signed a series of agreements with public institutions, businesses and CSOs.
10. The Department of Political Sciences refers a rich literature to students to realize the study program with online platforms, agreeable both to academic staff and to students of the Master of Science. Access to them is the same for everyone, both in the internal environments of UAMD and in the external ones of the new university campus.
11. The higher education institution has an internal institutional management system and makes it available for administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activity for the study program.
12. As an institution that is supported by the state budget, it is estimated that UAMD guarantees the funding and financial support necessary for the realization of the teaching-research process, the smooth running of the study program and the support of students.
13. UAMD and the Department of Political Science make available to students complete and detailed information on the educational objectives, structure, organization, content of the study program, expected learning outcomes and employment opportunities.
14. The higher education institution follows a clear policy for guaranteeing and promoting the quality of teaching and draws up special guidelines for the development of teaching according to state standards.



Weaknesses

1. There is a lack of a recent specific study of the labor market related to the MND study program.
2. The library has not been supplied with new textbooks to support teaching since 2016.
3. Lack of frequent public transport during study hours as the area where the new university campus is located is without a residential population, but suitable as a student campus.
4. Despite the satisfactory conditions offered by the UAMD building, and free surfaces in the surrounding environment, UAMD lacks sports and entertainment facilities for students.
5. Lectures translated by lecturers replace mandatory or supplementary literature, but in some cases they are not available in the Library to be equally accessible to all students.
6. The lack of third-cycle programs would increase the interest for students and academic staff with the title of professor.
7. The lack of supporting equipment such as video projectors in the auditoriums, for all lecturers, during the teaching process, which are necessary in some courses for the effectiveness of learning.

Recommendations

1. The Faculty should be reorganized so that Political Sciences are together with Social Sciences, since according to the international ISCED classification, Political Sciences are not in the same classification as Law, the former belong to category 3. Social Sciences, the latter to Category 4. Business Administration and Jurisprudence.
2. With the advancement from the Department of Political Sciences in the academic year 2023-2024 with a double degree Bachelor in International Sciences and Diplomacy with the University of Genoa, there is a need to revise the curriculum of this study program to strengthen the essential expertise in the field of international relations and diplomacy according to European experiences.
3. The Scientific Master's study program in "International Relations and Diplomacy" although it is informative, structured and organized in accordance with the predictions and formative objectives of the second cycle program, and according to the necessary components, it has faced challenges to adapted to the needs of international student mobility.
4. After nearly 5 years of implementation of this study program, there is a need for a specific study of the labor market related to the Master of Science study program in MND.
5. The study program enables and encourages students and lecturers to engage in studies, projects and research activities. However, there is a need for a clear institutional orientation for the academic staff of the study program in their involvement in academic research and publications.



6. Methods for both teaching and teaching evaluation can be expanded with other contemporary methods.
7. Procedures with a deadline of 10 days for the recruitment of ineffective staff should be increased and the bureaucratic documents for them should be reduced.
8. The Department of Political Science should add the necessary up-to-date physical literature to its library in support of teaching.
9. The RVB should have accurate references of the evidence, since throughout it there are inaccuracies in the number of evidences which do not correspond to those posted on the ASCAL website. More specifically, on page 56, two evidences with no. 208 and Evidence_No.107_Data from the official website of UAMD.
10. One suggestion from the conversations at UAMD was that the 10-day deadline for recruiting ineffective staff be increased and the bureaucratic documents for them such as health booklets, etc. be reduced.
11. The opening of the third cycle programs would increase the interest for students and academic staff with the title of professor.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

